

BIG DEAL

Monotoni e Qytetëruar?

Mbikqyrja Qytetare e Implementimit të Marrëveshjes Kosovë - Serbi

BigDeal!

“Më duket sikur jemi kthyer mbrapa dhjetë vjet, kur [si serb i Kosovës] më quanin tradhëtar pse isha pjesë e Kuvendit. Shpresoj që shpejt do të formohet qeveria sepse gjersa zhvillohej dialogu ne nuk kishim probleme.” —**PETAR MILETIC**

“Akoma nuk kemi liri të lëvizjes, dhe kjo është sfidë për autoritetet sepse nëse ka ndonjë pacient që sëmuret, e që ka nevojë të dërgohet diku, duhet të paguajë, ose me para, ose me jetë.”

—**SELATIN KACANIKU**

BIG DEAL

Monotoni e Qytetëruar

Kur implementimi i marrëveshjeve Kosovë-Serbi ka ngadalësuar deri në nivel të ecjes-zhagas, të dyja anët si dhe BE-ja duhet të rikthejnë në binarë vrullin për normalizim.

“Diploma ime njihet vetëm në shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Prindërit kanë investuar shumë në mua. Unë kam investuar duke bërë përpjekje të madhe për arsimim. Vite e vite mësim... Për çka? Për asgjë” —**DRAGIC BRDAR, NJË NGA 12,000 STUDENTËT QË STUDIOJNË NË UNIVERSITETIN PUBLIK TË MITROVICËS**

“Këto marrëveshje më nuk janë tërheqëse për Brukselin, Beogradin apo Prishtinën.”

—**BORKO STEFANOVIC,**
ISH NEGOCIATOR I SERBISË

Parathënie


Gazetari dhe shkrimtari H.H. Munro, i njohur me pseudonimin Saki, filim-vitet e 1900-ta i ka kaluar duke shkruar mbi Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913. Tregimet e shkurtëra që ai i ka bazuar në përvojat e tij në Ballkan, si “The Cupboard of Yesterdays” [Ormani i të Djeshmeve] paraqet jo vetëm personazhe të trilluara nga Ballkani por edhe mënyrën se si ato personazhe janë formësuar e komentuar nga ana e akterëve të Europës perëndimore.

Qysh para njëqind vjetësh, ai në tregimin e tij ka spekuluar se territori për të cilin luftohet dhe i cili pohohet si i veti nga ana e grupeve politike dhe etnike të Ballkanit do të jenë gjithmonë në pakësim e sipër, deri sa Europa jug-lin-

dore të mos ketë më parcela terriroresh të diskutueshme, të cilat do të jenë shndërruar në “Beks’hill të lindjes”, duke iu referuar me këtë një qyteti bregdetar të Anglisë, një paralageje të largët të Londrës afro 120 kilometra në juglindje.

Njëqind vjet e shumë luftëra më vonë, marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë, e ndërmjetësuar nga Bashkimi European, bart mbi vete premtimin për “normalizimin” e marrëdhënieve mes Serbisë dhe ish-provincave të veta, duke e zhvendosur Kosovën në “ormanin e të djeshmeve”, premtimin për sjellje të paqes jetëgjatë dhe të fundit.

Synimi i këtij projekti, Big Deal, është të monitorojë këtë proces të normalizimit, apo, siç e ka quajtur Munro, të “monotonisë së qytetëruar”.



“Pas secilës luftë të madhe të kohëve të fundit në Europën Jug-Lindore ka ardhur deri te tkurrja e shtrirjes së territorit kronikisht të trazuar... te një ndërhyrje e monotonisë qytetare... pluhuri i formalitetit dhe i pedantërisë byrokratike dalëngadalë do të rehatohet përmbi vendkujtimet kryesore të nderuara gjatë kohërave... gjithë ata emra e gjëra e vende të çuditshëm por që i kemi njohur aq gjatë si pjesë e si parcala të Çështjes Ballkanike - do të kalojnë në ormanin e të djeshmeve... E çka do të kemi për t’u përcjellur fëmijëve tanë? Mendoni për atë se çfarë lloj lajmesh do të kenë ata mbi Ballkanin pas dhjetë apo pesëmbëdhjetë vitesh... Ata do të shkojnë me veturë te ndonjë periferi e vendit, do të pijnë çaj, e nga aty do t’u shkruajnë të vetëve në shtëpi thua se shkruajnë për Beks’hillin e Lindjes”

—SAKI (H. H. MUNRO), “THE CUPBOARD OF THE YESTERDAYS” “[ORMANET E TË DJESHMEVE]

Mirënjohje

BIRN Kosova dhe Internews Kosova kanë hyrë në partneritet me CRTA nga Beogradi për të monitoruar implementimin e marrëveshjeve të ndërmjetësuar nga BE, duke vepruar si vrojtues të pavarur. Ky raport paraqet vetëm një pjesë të projektit tonë të gjerë, BIG DEAL, Mbikqyrja Qytetare e Implementimit të Marrëveshjes Kosovë – Serbi. Raporti është bërë i mundshëm me anë të mbështetjes nga Zyra Britanike për Punë të Jashtme, dhe nga Rockefeller Brothers Fund.

Për këtë raport kanë hulumtuar Vukosava Crnjanski, Rasa Nedeljkov, Ivana Savic, Misa Laketic, Vesna Radojevic dhe Jelena Bjelica nga CRTA, dhe Jeta Xharra, Faik Ispahiu, Nektar Zogjani Paulina Nushi, Bane Krstic dhe Bojana Barlovac nga BIRN Kosova dhe Internews Kosova. Raporti është shkruar nga Valerie Hopkins.

Hulumtimi mbështetet në intervistat me më shumë se 70 burime. Në mesin e bashkëbiseduesve janë përfshirë persona kyç nga procesi i dialogut nga Serbia, Kosova, dhe Brukseli, si dhe qytetarë të thjeshtë në jetën e të cilëve kanë pasur ndikim marrëveshjet si dhe niveli i implementimit të tyre. Kemi dhënë edhe referencat për burimet tona të para, si dhe të burimeve dytësore.

CRTA, apo Center for Research, Transparency and Accountability [Qendra për Hulumtim, Transparencë dhe Llogaridhënie], ka krijuar reputacion dhe besim të dëshmuar në mesin e publikut të Serbisë si organizatë që monitoron qeverinë dhe që vepron si avokat për vendimmarrje transparente dhe llogaridhënese. CRTA fuqizon qytetarin përmes informimit, si dhe mobilizon publikun për reagime kur zyrtarët publikë dhe institucionet shkelin përgjegjësinë e tyre llogaridhënese. Ndërkohë që ajo promovon llogaridhënien si vlerë themeltare të demokracisë, CRTA ushtron ndikim mbi zyrtarët publikë drejt përmirësimit të llogaridhënies ndaj publikut, për çelje të punëve të Kuvendit të Serbisë, dhe për transparencë më të lartë të buxheteve lokale.

BIRN Kosova dhe Internews Kosova bashkëpunojnë për të krijuar debat televiziv dhe emisione hulumtuese, të cilat kanë shikueshmërinë më të lartë në Kosovë, e janë shpërblyer edhe me çmime të shumta. Në shtator të vitit 2012, Internews Kosova dhe BIRN Kosova lansuan një platformë të re televizive, "Tema". Epizodi i parë solli shumë akterë nga të dy shtetet dhe i bëri bashkë ata në një debat të paprecedent ku u diskutuan shqetësimet e qytetarëve rreth standardeve të jetesës dhe rreth progresit, rëndësisë dhe interpretimit të vetëm një grusht marrëveshjesh të arritura deri në atë kohë. Nëntë debate televizive mbi çështje që shtrihen prej lirisë së lëvizjes e deri te bashkëpunimi kulturor janë transmetuar në kanalet kryesore edhe të Kosovës edhe të Serbisë.

Përmbajtja

—Parathënie	5
—Mirënjohje	6
—Përmbledhje ekzekutive	8
—Hyrje	12
—Ndryshimet që kanë ndikim tek serbët e kosovës, veqanërisht në komunat veriore	28
—Strukturat paralele	28
—Zgjedhjet	29
—Asociacioni i komunave	32
—Siguria	35
—Mbrojtja civile	36
—Gjyqësori	38
—Diskriminimi	39
—Shtresat: diplomat, regjistri i gjendjes civile, kadastri	39
—Regjistri civil	41
—Kadastri	41
—Kosova dhe bota	42
—Energjia dhe telekomi	44
—Përfundim	46

Përmbledhje ekzekutive

Nëse 2012-ta dhe 2013-ta ishin vite revolucionare për marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, viti 2014 deri tani ka qenë vetëm si njëfarë lloj shpërlarje. Pas vifesh tëhuajësimit dhe tensionesh, të dyja palët filluan në vitin 2013 të implementojnë marrëveshjet vendimtare të cilat i nënshkruan në 2011 dhe 2012. Pastaj në prill të vitit 2013 nënshkruan një marrëveshje – që u cilësua si historike – e cila i zhbllkoi Serbisë shtegun drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe e cila premtoi që do ta lëvizë Kosovën përpara në të njëjtin proces. Në vitin 2014 palët mbajtën disa takime, dhe vazhduan të implementojnë marrëveshjet teknike, por ky vit në përgjithësi ka qenë më shumë vit i pritjes se sa i veprimit.

Në vitin 2014 u pa një progres i kufizuar: katër komunit me shumicë serbe më në fund hynë nën kontrollin de jure të Prishtinës, ndonëse në terren ndikimi i kryeqytetit është praktikisht inekzistent. Qindra ish-policë të Serbisë u integruan në sistemin policor të Kosovës. Madje në shtator, Serbia doli me disa plane për pika kufitare të përbashkëta, sipas standardeve të BE-së, plane për të lejuar fluturimet e shqiptarëve të Kosovës nëpër aeroportin e Beogradit, si dhe një marrëveshje për zgjidhje të çështjes së transimisionit të energjisë. Madje, ministri i jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, bëri vizitën e tij të parë në Beograd më datë 23 tetor 2014, duke shënuar me këtë vizitën e parë që bën një ministër i Kosovës pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.¹

Megjithatë, momentum dhe vullneti i mirë i akumuluar para një viti zgjedhesh në Serbi, Kosovë, dhe në Parlamentin Europian, po zbehet. Për më shumë, Shërbimi i Veprimeve të Jashtme të Bashkimit Europian (European Union External Action Service EEAS) ka zhvendosur një pjesë të vëmendjes së tij nga Kosova dhe Serbia drejt konfliktit në Ukrainën Lindore. Zëvendësuesja e Baroneshës Kethrin Eshton, përfaqësuesja e re e punëve të jashtme Federica Mogherini, ka shansin që t'i injekttojë një gjallëri të re dialogut, por ajo duhet të sigurojë se, mes gjithë asaj që po ndodh në komshillëk të BE-së, do të prioritetizojë dialogun.

Katër komunit veriore kanë mbetur kryesisht jashtë fushëveprimit të Prishtinës, dhe vazhdon të jetë i pranishëm një nivel i ulët i dhunës. Në Mitrovicë kishte shkrepje të dhunës pas largimit të përkohshëm të barrikadës në urën e pjesës veriore të lumit Ibër dhe ngritjes së një “parku të paqes”. Ka pasur incidente të qëllimshme edhe në Serbi edhe në Kosovë, posaçërisht pas ndeshjes kualifikuese për Europian mes Shqipërisë dhe Serbisë.² Sa më shumë që të zgjasë status quo-ja në komunit veriore – më konkretisht, përderisa të mos ketë

1 Hoxhaj vizitoi Beograd si pjesë e një tubimi të sponsorizuar nga BE-ja për ministrat e qeverive nga Ballkani Perëndimor më datë 23 tetor 2014. Një vizitë e paraparë e presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga në Beograd më datë 1 nëntor 2014 e sponsorizuar nga një grup diskutimi perëndimor, u anulua. Presidentja Jahjaga tha se ajo kishte nevojë të qëndronte në Kosovë, për shkak të krizës së vazhdueshme politike. Për më shumë, shih Reuters, 31 tetor «Shturet takimi i propozuar i Liderëve të Ballkanit Perëndimor.» [Http://www.voanews.com/content/planned-meeting-of-western-balkan-nations-crumbles/2503182.html](http://www.voanews.com/content/planned-meeting-of-western-balkan-nations-crumbles/2503182.html)

2 Dy shtëpi të serbëve të kthyer në Kosovë u dogjën plotësisht, ndërsa kokteje molotovi u hodhën në selinë e njësisë e Mbrotjtjes Civile të Mitrovicës Veriore dhe në një kafene pronë serbe në Fushë Kosovë. Në Serbi, pati një vale zjarrvëniesh dhe vandalizmi në gjashtë biznese nën pronësi shqiptare në dy qytete të Serbisë, pas ndeshjes.

funksionim të gjykatave dhe Asociacion Serb të komunave, ka potencial për pakënaqësi dhe padurim.

Marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën do të jenë komponenti kryesor i bisedimeve të saj për pranim në BE. Kapitulli 35 i pakos së anëtarësimit, që zakonisht rezervohet për “çështje tjera”, në rastin e Serbisë do të trajtojë drejt për së drejti ecurinë e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. BE-ja ka bërë me dije në raportin e progresit për Serbinë për vitin 2014, se Kapitulli 35 duhet të hapet shumë herët dhe të vazhdojnë tok së bashku me kapitujt tjerë të hapur që Serbia do t'i përmbyllë, duke shtuar po ashtu se kjo duhet të jetë platformë për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura. Konventa Shtetërore për Bashkimin Europian, një koalicion prej 200 organizatash të shoqërisë civile, mendohet të shërbejë si platformë për angazhimin e qeverisë së Serbisë me publikun mbi çështjet e pranimit. Secili kapitull ka grupin përkatës punues në Konventë. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë thirrje publike për personat apo organizatat që të udhëheqin grupet e konventës. Udhëheqësia e Grupit Punues për Kapitullin 35 është nga një OJQ e cila nuk ka historik të vërejtshëm në marrëdhëniet Kosovë-Serbi, dhe është zgjedhur në mënyrë jo-transparente.³

Ky raport shqyrton të gjitha marrëveshjet e bëra mes Serbisë dhe Kosovës që kur ato filluan dialogun formal në Mars të vitit 2011, me ndërmjetësimin e BE-së dhe raporti jep këto rekomandime:

Për Kosovën, Serbinë dhe BE-në:

- Të sigurohet që veçori kyçe e çdo marrëveshje të jetë qartësia, dhe të zvogëlohet mundësia për të dy palët që të japin interpretime kundërtëhënëse. Marrëveshjet mbi integrimin e policisë kanë qenë të qarta, prandaj edhe janë implementuar; marrëveshjet mbi gjyqësorin dhe Asociacionin/Komunitetin e komunave serbe kanë qenë të vobekta dhe ngelin të paimplementuara.
- Të inkurajohet pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit nga komunat veriore në dialog, dhe të sigurohet përfshirja e tyre në komisionet implementuese. Të bëhen më shumë angazhime me qytetarët e thjeshtë për të siguruar se janë të informuar mbi atë që diskutohet në emër të tyre. Një sondazh i NDI i realizuar në shkurt, ka zbuluar se më pak se 10 përqind e serbëve të veriut dinin përmbajtjen e marrëveshjeve mbi gjyqësorin, duke theksuar kështu nevojën për informim më të mirë të qytetarëve përkitazi me marrëveshjet e kaluara por edhe ato të ardhshme.
- Të negociohet mbi një marrëveshje kohore mbi sigurimin e automjeteve në mënyrë që vozitësit nga Kosova dhe Serbia të mos paguajnë tarifa më të mëdha se banorët e shteteve tjera.
- Të hapen negociatat për të thjeshtësuar procesin joefikas aktual të regjistrimit të bizneseve me qëllim të tranzitit të mallrave nga Serbia në Kosovën e veriut.
- Të hapen negociatat mbi transportin hekurudhor dhe trafikun ajror. Të zg-

³ Informimi nga bisedat me disa ekspertë nga Beogradi dhe OJQ që punojnë me çështje të Kosovës dhe të tjera.

jerohet dialogu mbi çështjet e personave të zhdukur dhe mbi trashëgiminë kulturore.

- Të përmirësohen kapacitetet dhe mundësitë e zyrtarëve ndërlidhës.
- Të vendoset linjë direkte komunikimi mes Beogradit dhe Prishtinës e cila nuk ka nevojë për ndërmjetësim të EULEX-it, meqë Misioni i BE-së për sundim të ligjit është duke reduktuar praninë dhe planifikon të tërhiqet qysh në vitin 2016.

Për Kosovën:

- Të formojë qeverinë me efikasitet ekspeditiv ashtu që Prishtina të ketë palën e saj me të cilën mund të vazhdojë implementimi i marrëveshjeve dhe që të mund të vazhdojë dialogu i mëtutjeshëm.
- Të angazhohet më shumë me serbët e Kosovës nëpërmjet kanaleve zyrtare.
- Të sigurojë që organet përkatëse të hetojnë çfarëdo akuze për dhunë ndaj komuniteteve pakicë, në mënyrë që të tregojë përkushtim ndaj sigurisë së minoriteteve në Kosovë.
- Të gjejë zgjidhje lidhur me njohjen e diplomave të serbëve që kanë kryer studimet në Universitetin e Mitrovicës.
- Të miratojë ligjin për kadastër, i cili ka ngecur në Kuvendin e Kosovës.

Për Komunat veriore në Kosovë:

- Të sigurojë lirinë e lëvizjes për EULEX-in në mënyrë që të implementojë marrëveshjen.
- Të gjejë mënyrën zyrtare për të informuar banorët lidhur me atë se kush nga komuniteti është pjesë e bisedimeve në Bruksel dhe në ekipet e implementimit. Të angazhojë banorët për informim të tyre lidhur me statusin e implementimit të marrëveshjeve dhe atë se çfarë rëndësie do të ketë kjo në jetën e tyre.
- Të largojë nga ura e lumit Ibër çdo barrierë ndaj lirisë së lëvizjes.

Për Serbinë:

- Të sigurojë që diskutimet rreth Kapitullit 35 për bisedimet e pranimit në BE të jenë transparente dhe të sigurojë pjesëmarrje të fortë të grupeve të shoqërisë civile.
- Të mbajë zotimin për bashkëpunim rajonal, duke përfshirë lejimin e Kosovës për pjesëmarrje në organet dhe forumet rajonale.
- Të patullojë fuqishëm rrugët dhe shtegkalimet ilegale në veriun e Kosovës që përdoren nga kontrabanduesit.⁴
- Të gjejë zgjidhje ligjore për të tejkaluar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat disa prej marrëveshjeve i konsiderojnë si jokushtetuese.
- Të njohë diplomat e Universitetit të Prishtinës dhe të universiteteve të tjera të Kosovës.

⁴ Në raportin e progresit 2014 për Serbinë, Komisioni Europian i kërkoi Serbisë që të marrë "masa shtesë" për të ndaluar kalimet e paligjshme.

- Të largojë barrierat që pengojnë Kosovën të marrë kodin e vetë telefonik.
- Të shpërbëjë strukturat e Mbrojtjes Civile dhe të integrojë punonjësit e saj në institucionet përkatëse të Kosovës.
- Të bëjë të mundshme që poseduesit e pasaportave ndërkombëtare që të udhëtojnë nga Kosova në Serbi pa pasur nevojë që së pari të hyjnë në Serbi.

Për BE-në:

- Të ndërmerr qasje më aktive në diskutimin e hapur të asaj se palët janë apo nuk janë duke iu përmbajtur anës së vet të marrëveshjes. Ta bëjë këtë duke i bërë të gjitha marrëveshjet publike dhe duke qenë e zëshme rreth niveleve të implementimit nga secila anë. Të monitorojë implementimin dhe t'i bëjë publike raportet e monitorimit.
 - Të këmbëngulë për implementim të marrëveshjeve ekzistuese, duke përfshirë gjyqësorin, kodin telefonik, diplomat, kadastrin, dhe Asociacionin/Komunitetin e komunave serbe.
 - Të vazhdojë që me dialogun ta mbajë të kushtëzuar pragjet e progresit të pranimit në BE. Si kusht për status kandidati, Serbia është pajtuar që t'i transferojë Kosovës strukturat e sigurisë dhe drejtësisë. Marrëveshja është bërë, dhe Serbia ka hapur negociimet. Që nga atëherë, është bërë shumë pak progres substancial në gjyqësor. BE-ja duhet të këmbëngulë për implementim të plotë të zotimeve të Serbisë.
 - Përfaqësuesja e lartë, Mogherini, duhet të rigjallërojë momentumin e dialogut duke organizuar takime të nivelit të lartë sa më shpejtë që Kosova të formojë qeverinë, për të treguar se kjo çështje mbetet prioritet kryesor.
 - Të hap qysh herët diskutimet për kapitullin 35 për integrim në BE dhe ta zbatojë atë horizontalisht me kapitujt tjerë. Të monitorojë vazhdimisht progresin.

Hyrje

Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë kanë qenë të tëhuajësuar për vite të shumta, pas përfundimit të luftës mes njëra-tjetrës në vitin 1999, ndërkaq armiqësia mes tyre u përkeqësua me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008. Shqiptarët e Kosovës kishin vështirësi të udhëtimit lirshëm në Serbi, madje edhe si tranzit për në vende të treta. Ekonomia e Kosovës u ngadalësua nga një lloj embargoje tregtare e Serbisë, dhe telekomunikacioni si dhe sistemi i shpërndarjes së energjisë teknikisht mbetën nën kontrollin e Serbisë.

Në vitin 2011, me sforcim nga ana e Bashkimit European, dy qeveritë filluan të takohen rregullisht për të trajtuar disa çështje teknike mes tyre. Ata së pari trajtuan marrëveshjet teknike rreth infrastrukturës, lëvizjes së lirë në mes të dy territoreve, kthimin e librave të regjistrit civil dhe njohjen reciproke të diplomave, dhe më vonë filluan të pajtohen në nivelet më të larta politike për “normalizim të marrëdhënieve.”

Negociatori serb, Borko Stefanovic, i cili atëherë shërbente si drejtor politik i ministrisë së jashtme të Serbisë, zhvilloi bisedime të gjerësishme me zëvendës kryeministren e Kosovës, Edita Tahirin. Këto bisedime fillimisht teknike janë paraqitur si kronikë në një dokumentar një-orësh me titull “Marrëveshja”, të sponsorizuar nga Bashkimi European, ku tregohet se si të dy negociatorët arritën më në fund tek vendimi që secili të bëjë koncesione duke synuar përmirësimin e lidhjeve funksionale midis vendeve të tyre, dhe tregon si ndërmjetësuesi i BE-së, Robert Kuper, ishte vendimtar në këtë proces.

Më në fund, përfaqësuesja e lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Kethrin Eshton, arriti me sukses që të sjellë në tryezën e Brukselit si Kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin, ashtu edhe atë të Serbisë, Ivica Dačić, në tetor të vitit 2012. Ky ishte takimi i parë zyrtar në nivel kryeministror pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Të dyja palët u pajtuan për shkëmbim të zyrtarëve të ndërlidhjes, për formim të një njësie të veçantë multi-etnike të Policisë së Kosovës për mbrojtje të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, dhe për kryerje të një studimi mbi fizibilitetin e një autostrade Prishtinë - Nish.

Më 19 prill, 2013, të dyja palët nënshkruan “marrëveshjen e parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”. Ndërkohë që marrëveshjet teknike fokusoheshin në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, «Marrëveshja e Brukselit» siç filloi të njihet ajo, fokusohet kryesisht në të ardhmen e popullatës etnike serbe të Kosovës. 15 pikët e marrëveshjes i dhanë Prishtinës de jure kontrollin mbi komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe, duke u garantuar serbëve që jetojnë atje autonomi të kufizuar nëpërmjet një njësie të Policisë së Kosovës që udhëhiqet nga serbët, Gjykatës së Apelit me shumicë serbe, dhe akoma të paformuarit Asociacion/Komunitet⁵ të komunave serbe. Në maj, palët u pajtuan rreth planit të parë të implementimit.

Marrëveshja u prit me shumë bujë në Bruksel, dhe u cilësua si arritje revo-

⁵ Marrëveshja përdor dy terme paralelisht, pasi që për strukturën nuk u ra dakord në Bruksel.

lucionare që do të siguronte paqe të qëndrueshme mes ish armiqve të moçëm. Pjesëmarrja e qeverive të të dyja vendeve ka qenë shumë e ndikuar nga nevoja e tyre për ta kënaqur BE-në, të cilës të dyja shpresojnë t'i bashkangjiten. Serbia ka qenë në gjendje që nëpërmjet këtij procesi ta kalibrojë atë që ajo ia pranon Kosovës, pa e njohur zyrtarisht shtetësinë e Kosovës. Akti më i vështirë balancues për të ka qenë që të bie dakord për shpërbërjen e strukturave shtetërore që veprojnë në të gjithë territorin. Në shkëmbim për këtë, autoritetet e Kosovës u pajtuan që të njohin autonomi të kufizuar për katër komunat më të mëdha serbe në veriun e Kosovës, dhe të lejojë themelimin e një asociacioni të komunave serbe. Nga ana e Kosovës, procesi i ka dhënë qytetarëve të saj një qasje për në Serbi – në të cilën ata më parë nuk mund të udhëtonin, dhe mbanin të hapur perspektivën e shtrirjes së kontrollit në të gjithë territorin e Kosovës.

Si ndërmjetës, Bashkimi Europian fitoi të drejtën që ta deklarojë këtë si një sukses të politikës së jashtme, një pendël në kapelën e Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes (CSDP). Serbisë iu dha një datë për fillim të bisedimeve për pranim në janar të vitit 2014, dhe Kosova përparoi në negociatat për nënshkrim të marrëveshjes së stabilizim asociimit.⁶

Megjithatë, ndërkohë që lëvdatat vazhdojnë nga Brukseli, politikanët të cilët negociuan për të dyja palët morën kritika nga ana e zgjedhësve të vet. Dy të tretat e serbëve nga Serbia mbështesin dialogun me Kosovën, ndërkaj që atë e mbështesin vetëm gjysma e shqiptarëve të Kosovës, dhe më pak se dhjetë përqind e serbëve të Kosovës nga komunat veriore të Kosovës mendojnë se Kosova është duke shkuar në drejtim të duhur (krahasuar me shqiptarët, 24 për qind).⁷ Serbia është kritikuar nga nacionalistët për njohje efektive të shtetësisë së Kosovës, ndërkohë që zëvendës kryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, dhe qeveria që përfaqëson ajo u akuzuan për atë se kanë cementuar statusin si geto të Kosovës ndërkohë që Serbisë i kanë dhënë leje falas për Europë. Kritikët thonë se Brukseli ka joshur kryeministrin serb, Aleksandar Vuçiq, dhe kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin, duke u mundësuar të dyve dorë të lirë në devijim qeverisjeje përdorur dialogu vazhdon të qëndrojë në binarë.

Marrëveshjet janë bërë prapa dyerve të mbyllura në sallat e Brukselit. Ndonëse dihet se në çka është rënë dakord në parim, shpesh, informacioni i plotë lidhur me takimet dhe marrëveshjet e arritura nuk arrijnë tek publiku. Kosova ka publikuar nëntë nga marrëveshjet teknike, ndërsa Serbia ka publikuar gjashtë.⁸

“Po mungon transparenca”, tha për BigDeal udhëheqësja e Zyrës Administra-

6 MSA u nënshkrua në Bruksel më 25 korrik 2014 dhe ka gjasë që të miratohet nga Këshilli i Bashkimit Europian në pranverë të vitit 2015. Është me rëndësi të theksohet këtu se MSA e Kosovës paraqet një MSA të nënkrahasuar, ndryshe nga ato të nënshkruara nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Ajo nuk është ratifikuar nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, sepse 5 anëtarë të BE-së ende nuk e njohin Kosovën. Kjo MSA nuk e ka vënë Kosovën në të njëjtën rrugë drejt BE-së sikurse fqinjët e saj.

7 Sondazhi i kryer nga Instituti Kombëtar Demokratik në shkurt 2014. <https://www.ndi.org/files/NDI-Kosovo-Feb-2014-Public-Opinion-Research-on-Brussels-Agreement.pdf>

8 Serbia nuk ka publikuar në faqen e saj marrëveshjet për Energji, Telekom apo Diploma. Për marrëveshjet në faqen e Serbisë, shih <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/index.php?id=82315>. Për marrëveshjet në faqen e Kosovës, shih <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,191>.

tive të Mitrovicës Veriore, Adrijana Hodzic.⁹ “Nuk mund t’ju jap përgjigje në atë se sa qytetarë nga Mitrovica Veriore janë të përfshirë në diskutimet e vazhdueshme. Ne nuk e dimë as se sa grupe kemi të cilat merren me çështjet e ndryshme. Kemi probleme në lidhje me policinë, gjykatat, vetëqeverisjen lokale, etj.

Megjithatë, shumica e dokumenteve që janë në dispozicion nuk japin shpjegim për detajet e plota të mënyrën se si duhet të zbatohen marrëveshjet. Kjo ka çuar në keqkuptime, ndërsa ata tek të cilët kjo gjë ka më së shumti ndikim në jetën e përditshme mbesin në errësirë sa i përket asaj që është negociuar në emër të tyre, dhe prandaj nuk mund të ushtrojnë të drejtat që përcaktohen në marrëveshje.

Mungesa e vetëdijësimit është manifestuar me mospëlqim dhe mosbesim ndaj marrëveshjeve. Anketat e fundit kanë treguar se gjysma e shqiptarëve nga Kosova janë kundër dialogut aktual, dhe se kundër tij janë dy të tretat e serbëve të Kosovës.¹⁰

Megjithatë, ndërkohë që qytetarët besojnë se janë të informuar për të, vazhdon që mosinformimi të jetë i pranishëm. Për shembull, e njëjta anketë ka zbuluar se shtatë nga dhjetë të anketuar në Kosovën veriore besojnë se marrëveshja parasheh një forcë të re sigurie në veri, gjë që nuk është ashtu. Madje, më pak se gjysma e serbëve të Kosovës veriore janë në dijeni rreth kompetencave të Asociacionit të Komunave Serbe. Ndonëse shqiptarët e Kosovës kanë mendim të lartë për dobritë personale nga marrëveshja, ata tregojnë se janë më pak në dijeni për këtë: dy të tretat kanë deklaruar se nuk kanë “lexuar apo dëgjuar për marrëveshjen”.

Përfshirja e akterëve nga komunat veriore, dhe transparenca rreth përfshirjes së tyre, sipas Hodzic, paraqet të vetmen mënyrë për ta fituar interesimin e komunitetit lokal.

“Na duhet të dimë se kush po bisedon për këto çështje lokale, dhe kur njerëzit ta shohin se në këto delegacione kanë persona adekuat që flasin për këto çështje, atëherë do të sigurohet se populli ka kuptuar faktin se kemi njerëz të mirë që na përfaqësojnë ne dhe nevojat tona.”

Paqartësia e disa marrëveshjeve në disa raste ka çuar edhe në interpretime të kundërta për atë se si duhen zbatuar, gjë që u ka dhënë të dy anëve kohë dhe hapësirë për të promovuar mendime të kundërta për mënyrat e realizimit të implementimit. Për shembull, një prej komponentëve kyç të Marrëveshjes së Brukselit është Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe. Fakti se janë përdorur dy fjalët ka bërë që të dalin dy interpretime të ndryshme rreth strukturës, kapacitetit, dhe rolit që do të ketë ky organ pasi të jetë formuar, duke ngritur pritjet e qytetarëve nga ajo se si preferojnë ta shohin atë, të dobët apo të fortë.

Sidoqoftë, disa zhvillime kryesore që dikur dukeshin të pamendueshme, si krijimi i komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës nën qeverisje të Prishtinës, tashmë veç ka ngjarë, ndonëse fushëveprimi konkret i Prishtinës mbetet i kufizuar dhe është Beogradi ai që akoma vazhdon të ushtrojë ndikim dhe autoritet

9 Kjo është një zyrë në Mitrovicën e Veriut nën qeverinë e Kosovës e cila ka funksionuar që nga maji i vitit 2012, ku qytetarët mund të kenë qasje në shërbimet e nevojshme komunale nga institucionet e Kosovës.

10 Po aty.

të konsiderueshëm. Gjithashtu, integrimi i serbëve të veriut të Kosovës në forcat policore të Kosovës ka shtruar themel të fortë për përparim.

Megjithatë, progresi nuk është i pakthyeshëm dhe shumë çështje mbesin të hapura. Nuk ka pasur asnjë përparim në shkëmbimin e dokumenteve kadastrale, asnjë përparim në formimin e sistemit të bashkuar gjyqësor për veriun e Kosovës, dhe një shpërthim në qershor mbi barrikadën në urën kryesore në mes të pjesës veriore dhe jugore të Mitrovicës ka mbetur e pazgjidhur.

Ish-negociatori serb, Borko Stefanovic, ka thënë për BigDeal se pas marrëveshjes së 19 prillit, të gjitha partitë kanë humbur momentumin e tyre në pjesën e implementimit të marrëveshjeve teknike.

“Këto marrëveshje nuk janë më tërheqëse për Brukselin, Beogradin apo Prishtinën”, shtoi ai. “Unë besoj se qeveria jonë, si dhe [e Kosovës] thjesht i kanë marrë marrëveshjet Stefanovic-Tahiri si zero, si të pavlefshme, ose të parëndësishme. Pothuajse Marrëveshja e Brukselit¹¹ gëlltiti çdo gjë. Pothuajse ekziston ndonjë marrëveshje e heshtur midis dy qeverive që të mos këmbëngulin edhe shumë, ndërkohë që BE-ja u thotë ‘e kemi një marrëveshje të re flakë, e cila është lodër shumë më interesante se marrëveshjet teknike’”.¹²

Këtë vit, procesi i implementimit u komplikua edhe më tej nga zgjedhjet në Serbi në muajin mars. Zgjedhjet e Parlamentit Europian në maj forcuan anën e Euro-skeptikëve, gjë e cila ka shuar shpresat e vendeve kandidatë për anëtarësim në të ardhmen e afërt. Këtë vit implementimi i marrëveshjeve dhe dialogu i vazhdueshëm është penguar në masë të madhe nga zgjedhjet e parakohshme në Kosovë në muajin qershor, shoqëruar nga ngërçi politik që po vazhdon edhe gjatë muajit Nëntor, ku vendit ende i mungon qeveria.

Mes muajit mars dhe shtator, ka pasur shumë pak progres në implementim, por vonesat e shkaktuara nga ana e zgjedhjeve ishin vetëm një pjesë të problemit. Komponentet e marrëveshjeve që janë artikuluar qartazi në tekst dhe janë definuar mirë, sikurse integrimi i policisë, miratimi i një ligji për amnisti në Kosovë, si dhe kthimi i dokumenteve të regjistrimit civil – janë zbatuar. Mirëpo pjesa më e madhe e Marrëveshjes së Brukselit është e mbushur me paqartësi. Mosqartësia ka qenë e dobishme për të bërë finesën e marrëveshjeve mes dy palëve, por paraqet pengesë në implementim të tyre, gjë që është arsye pse ka pasur progres të paktë në Asociacionin/Komunitetin e komunave veriore dhe integrimin e gjykatave në Mitrovicë/Vushtrri, ku asnjëra prej tyre nuk ishte e definuar mirë as në tekstin e marrëveshjeve. Madje, “Civilna Zastita” serbe, apo strukturat e Mbrojtjes Civile, që janë aktive në katër komunat veriore, nuk janë shpërbërë. Përkundrazi, ato po punësojnë punonjës të rinj, sipas një interviste me një politikan të lartë serb dhe anëtar të parlamentit të Serbisë.¹³

11 Marrëveshja në Bruksel, që gjithashtu referohet si marrëveshja e 19 prillit, i referohet marrëveshjes së nënshkruar mes dy kryeministrave Thaçi dhe Daçiç, më 19 prill 2013, për dallim prej marrëveshjeve teknike të negociuara nga Tahiri dhe Stefanovic.

12 Kjo intervistë është kryer më 23 shtator, vetëm pak ditë pasi u arrit plan i ri implementues për lirinë e lëvizjes, që lejon shqiptarët e Kosovës të udhëtojnë përmes aeroportit të Beogradit, dhe hapjen e kufijve të rinj të tranzitit midis Serbisë dhe tre vendeve tjera.

13 Intervistë me Aleksandar Jablanovic, udhëheqës i Srpska Lista-s dhe deputet në parlamentin

Kjo situatë aktuale pjesërisht e implementueshme ka lënë hapësirë për një lloj vakumi të rrezikshëm në veri. Në shtator të vitit 2013, të ashtuquajturat “gjykatat paralele”, apo gjykatat penale të financuara nga Serbia, ndalën së pranuari raste të reja, në pajtim me planin e implementimit, i cili ka parashikuar se do të krijoheshin dhe niseshin gjykata të reja nën sistemin e Kosovës, por ato nuk janë bërë. Gjersa EULEX-i merret vetëm me raste të lidhura me krimin e organizuar, korrupsion dhe krime të luftës, ka një vakum serioz gjyqësor në katër komunat veriore.

“Kam frikë se ka një lloj vakumi ligjor, veçanërisht kur është fjala për krimin, e veçanërisht për krimet për të cilat dënimi është deri në dhjetë vjet burg, e të cilin vakum e përdorin njerëzit qëllim-keq”, tha negociatori serb dhe njëkohësisht drejtor i zyrës së Serbisë për Kosovën, Marko Gjuric, për BigDeal.¹⁴

Me kohën që po kalon dhe s’ka implementim të plotë, Bashkimi Europian është vënë në test dhe në pozitë të palakmueshme nga vetëbesimi rus, që po rrezikon sigurinë e bllokut.

Përveç kësaj, lodhja nga zgjerimi ka qenë më pak e rëndë. Shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, baronesha Kethrin Eshton, është duke i dorëzuar drejtimin Ministres së Jashtme italiane Federica Mogherini-t, mu në kohë kur mundësia për tu përqëndruar në përparimin e Ballkanin Perëndimor ka gjasë që të jetë shpërqëndruar nga konflikti në Ukrainë.

Gjersa koha kalon pa takime të reja të nivelit të lartë, dhe gjersa nuk ka përparim, mund të lindin probleme, si ato që ndodhën në 14 tetor 2014 me ndeshjen e braktisur të futbollit Serbi-Shqipëri. Ndeshja u mbyll pasi një fluturake e telekomanduar valoi flamurin e “Shqipërisë së madhe” u shfaq mbi stadium, dhe pas përleshjeve mes lojtarëve të dy ekipeve, si dhe spektatorëve, pasoi dhunë ndaj bizneseve nën pronësi shqiptare në Serbi dhe ndaj komuniteteve të serbëve të kthyer në Kosovë.

“Pas ndeshjes së futbollit, ndjehem sikur jemi kthyer mbrapa dhjetë vjet, kur [si serb i Kosovës] më quajtën tradhëtar pse isha në Kuvend”, tha Petar Miletic, ish zëvendës kryetari i Kuvendit të Kosovës për BigDeal. “Shpresoj që shpejt do të vijë qeveria në Kosovë, sepse gjersa zhvillohej dialogu ne nuk kishim probleme.”

Pas pesë muajsh nga zgjedhjet e përgjithshme, Kosova ende nuk ka formuar qeveri. Në ekzistoftë një përftim në këtë amulli të vazhdueshme politike, është se ka afuar përfaqësuesit serbë më afër Prishtinës, meqë ata marrin pjesë në negociatat për koalicionet qeverisëse.

“E fillë është jeta ime momentalisht, që të jem dy herë në javë në Prishtinë, dhe dy herë në javë në Beograd”, tha për BigDeal, Aleksandar Jablanovic, kreu i bllokut më të madh serb, Srpska LISTA-s, rreth pjesëmarrjes së tij në bisedimet për formimin e qeverisë.

e Serbisë nga radhët e Partisë Socialiste të ministrit të punëve Vulin, i cili është pjesë e komisionit parlamentar të Serbisë për Kosovën.

14 Intervistë me Marko Djuric, përfaqësues i delegacionit të Serbisë, më datë 25 shtator 2014.

Marrëveshjet

Kur negociatori i Beogradit, Borko Stefanovic, që atëherë shërbente si drejtor politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, dhe zëvendës-kryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, filluan të takohen në mars të vitit 2011, u shënua hera e parë që Serbia dhe Kosova hynë në negociata që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Takimet ishin rregullisht lajmi i faqes së parë dhe negociatorët nuk qenë famë-mirë për publikun e tyre përkatës. Negociatorët nënshkruan marrëveshjet e para në po atë muaj të korrikut. Në të njëjtin muaj, shpërtheu dhunë përgjatë kufirit, kur policia e Kosovës u përpoq të marrë nën kontroll pikat kufitare dhe të vendosë doganat e Kosovës për mallrat që kalojnë. U desh të ndërhyjnë paqeruatjtësit e NATO-s për të stabilizuar situatën.

Gjatë raundit teknik të të ashtu-quajturit “dialog”, partitë e Kosovës dhe ato të Serbisë u pajtuan për pikat në vijim, të cilat janë përmbledhur dhe paraqitur në renditje kronologjike:¹⁵

pjesërisht e
përfunduar

Liria e lëvizjes: Më datë 2 korrik 2011, të dy palët u pajtuan që banorët e vendeve përkatëse duhet të jenë në gjendje të udhëtojnë lirshëm “brenda territorit apo nëpër territorin e tjetrit”. Kjo do të lehtësohej përmes një sistemi kartelash Identifikimi për udhëtimet “në anën tjetër kufitare” të banorëve të tjetrës palë, përmes përdorimit të dokumenteve të hyrjes/daljes. Të dyja palët u pajtuan që të mundësojnë banorët e palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të tjetrit. Partitë u pajtuan edhe për zgjidhje të përkohshme të blerjes së një sigurimi të përkohshëm, gjersa do të punojnë për një aranzhman komercial për sigurim reciprok të automjeteve.

përfunduar

Regjistri Civil: Po ashtu më datë 2 korrik 2011, të dyja palët u pajtuan se një komision trepalësh i përbërë nga ekspertë të regjistrimit civil nga të dyja palët dhe i kryesuar nga Misioni i BE-së për sundim të ligjit, EULEX-i duhet të identifikojë zbratësirat e librave të regjistrimit të para vitit 1999. Serbia është pajtuar që të bëjë kopje të regjistrave origjinalë, të cilat, pas certifikimit nga ana e EULEX-it, do t'i kthehen Kosovës.

nuk ka
progres

Kadastr: Më datë 2 shtator 2011, palët u pajtuan që të sigurojnë regjistrin e plotë kadastral për Kosovën përmes një procesi të ngjashëm siç është përcaktuar në marrëveshjen e regjistrimit civil: Ekipe të trepalëshe, të kryesuar nga BE-ja, do të skanonin dhe verifikonin dokumentet që datojnë para vitit 1999. Secili do të krahasohej nga ana e një agjencie teknike brenda Kosovës, dhe në rast të mospërputhjes, do të trajtohej nga një mekanizëm gjykues, dhe ku ankesat do të shqyrtoheshin nga Gjykata Supreme e Kosovës.

¹⁵ Teksti i plotë i marrëveshjeve mund të gjendet në faqen e Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2.191> dhe në faqen e qeverisë së Serbisë: <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/index.php?id=82.315>.

Vulat Doganore: Më datë 2 shtator 2011, palët u pajtuan të pranojnë vulat e Doganës së Kosovës dhe premtuan se do të sigurojnë liri të lëvizjes për mallra në pajtim me CEFTA-n, Marrëveshjen e Europës Qendrore për Tregti të Lirë.¹⁶

përfunduar

Njohja Reciproke e Diplomave: Më datë 21 nëntor 2011, të dy palët u pajtuan që të kërkojnë nga Shoqata e Universiteteve Europiane certifikimin e diplomave universitare, qoftë për arsim të lartë apo për punësim në sektor publik. BE-ja ka thënë se do të bëjë çdo përpjekje për të filluar implementimin që në janar të vitit 2012.

pak progres

IBM¹⁷: Në kontekst të BE-së, IBM nënkupton “Integrated Border Management” (Menaxhim të Integruar të Kufirit), dhe paraqet komponentë kyçe për anëtarësim në BE. Për shkak që Serbia nuk e njeh Kosovën, ajo preferon termin “Integrated Boundary Management” (Menaxhim të Integruar të Vijë-kalimit kufitar). Në negociatë, është përdorur vetëm “IBM”, që është neutral ndaj statusit. Më datë 2 dhjetor 2011, palët u pajtuan që të zbatojnë konceptin e IBM-së të paraqitur nga BE-ja, duke u pajtuar që gradualisht të vendosin pikat e përbashkëta kufitare “sa më shpejtë që është praktikisht e mundshme”. Ato u pajtuan që secila anë të ketë staf të balancuar në to, dhe të mos shfaqen simbole shtetërore. Palët janë pajtuar edhe për atë që në gjashtë pikat e kalimit kufitar të jenë të pranishëm zyrtarët e EULEX-it.

pak progres

Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi Rajonal: Më datë 24 shkurt 2012, palët u pajtuan në baza të përkohshme, që në organet rajonale emri i Kosovës të shfaqet me fusnotë e cila i referohet Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së dhe mendimit të Gjykatës ndërkombëtare mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Më tutje, ato u pajtuan për atë se në çfarëdo marrëveshje të re Kosova do të shfaqet me fusnotë.

pak progres

Telekomi: Më datë 8 shtator 2013, palët u pajtuan se BE-ja dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit do t'i ndajë Kosovës 3-shifrorin e kodit telefonik, dhe që deri në muajin janar 2015 t'i kalojë në atë kod tre linjat që janë në përdorim në Kosovë (Serbia linjën tokësore, Sllovenia dhe Monako linjat celulare). Palët u pajtuan gjithashtu për harmonizim të Sistemit Global të Komunikimeve Mobile (GSM) dhe sinjalit televiziv, ku të dyja palët u pajtuan që të mos mbulojnë qëllimisht “kufirin/vijëkufirin” e tjetrit.

nuk ka progres

Energjia: Palët janë pajtuar se organet e transmisionit të energjisë, KOSTT i Kosovës dhe EMS i Serbisë do të nënshkruanin marrëveshje bilaterale brenda tre muajve, me të cilët vendosin dhe rregullojnë marrëdhëniet mes dy operatorëve të sistemit të transmisionit. Të dy rregullatorët do të mund të lëshonin leje për

pjesërisht e përfunduar

¹⁶ Në vitin 2006, Serbia, në kuadër të CEFTA-s, pranoi Kosovën si zonë të pavarur doganore.

¹⁷ Ndërkohë që Kosova e quan vijën ndërmjet vetes dhe Serbisë Kufi, Serbia i referohet asaj si “Vijë kufitare”.

tregti (import, eksport, tranzit) dhe të furnizojnë kompanitë distributive përkatëse. Palët janë pajtuar edhe për atë se do të themelojnë kompani të re brenda ligjit të Kosovës, e cila do të ofronte shërbime furnizimi për komunat veriore me shumicë serbe. Kosova dhe Serbia u pajtuan edhe për atë se, në një kohë të ardhme, do të gjejnë metodë të përbashkët për të rehatuar ankesat që të dyja i kanë ndaj njëra tjetrës lidhur me shfrytëzimin e linjave të transmisionit, me synimin që të kërkojnë arbitrazh ndërkombëtar në rast se nuk vjen asnjë zgjidhje brenda 6 muajsh.

Secila nga marrëveshjet ka obliguar planin e implementimit dhe komisionin e implementimit për të mbikëqyrur progresin e marrëveshjes.

Baronesha Kethrin Eshton bëri bashkë dy kryeministrat për të rënë dakord mbi “Marrëveshjen e Parë mbi Parimet Qeverisëse për Normalizim të Marrëdhënieve”, të nënshkruar më 19 prill 2013. Në të përmbahen marrëveshjet në vijim:

përfunduar

Themelimi i katër komunave: Palët u pajtuan që të organizoheshin zgjedhje komunale në katër komunat e veriut, në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në pajtim me ligjin e Kosovës, dhe në pajtim me standarde ndërkombëtare.

nuk ka
progres

Themelimi i Asociacionit/Komuniteti i komunave serbe:

Palët janë pajtuar që pasi të përfundojnë zgjedhjet, të krijohej Asociacioni/Komuniteti i dhjetë komunave me shumicë serbe në Kosovë, i cili do të kishte “pasqyrë të plotë të sferave të zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural”, dhe kompetenca të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Anëtarësimi në të është i hapur për çdo komunë tjetër, përderisa të gjithë anëtarët të jenë dakord. Ai do të krijohet me statut, mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës. Komunat pjesëmarrëse “do të kenë të drejtë të ushtrojnë kompetencat e tyre përmes Asociacionit/Komunitetit”, në përputhje me Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligjit të Kosovës. Ky organ do të ketë rol përfaqësues para autoriteteve qendrore dhe do të ketë një ulëse në këshillin konsultativ të bashkësive për këtë qëllim.

pjesërisht e
përfunduar

Policia dhe Siguria: Policia e Kosovës (PK) do të jetë e vetmja polici që vepron në territorin e Kosovës. Të gjitha forcat policore që veprojnë në veriun e Kosovës do të integrohen në PK dhe pagat do të paguhën nga ky organ. Pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë do t’u ofrohet mundësi në strukturat ekuivalente të Kosovës.

Mbikqyrjen e katër komunave veriore me shumicë serbe (Mitrovicë të veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviç) do ta ketë një komandant rajonal. Ky komandant do të jetë serb, dhe do të emërohet nga Ministri i Brendshëm “nga lista që ofrohet nga katër kryetarët e komunave në emër të Asociacionit/Komunitetit”. Përbërja e njësisë rajonale do të pasqyrojë përbërjen etnike të katër komunave. Do të vendoset një tjetër komandant rajonal për Mitrovicën e jugut, Skënderaj, dhe Vushtrinë, mirëpo komandanti rajonal i njësisë që mbulon katër komunat do të bashkëpunojë me komandantët tjerë rajonalë.

Gjyqësori: Palët janë pajtuar se autoritetet ekzistuese të gjyqësorit do të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të krijojë panel të përbërë nga shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovë për të trajtuar të gjitha komunitet me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga gjyqtarë dhe staf administrativ, do të ketë selinë permanente në Mitrovicën e veriut. Gjykatës serb të Kosovës do të përbëjnë shumicën e secilit panel.

nuk ka
progres

Tjera: Të dyja palët janë pajtuar se diskutimet mbi energjinë dhe telekomin do të intensifikohen nga ana e të dyja palëve dhe do të përfundohen deri më 15 qershor 2013.

pjesërisht e
përfunduar

Të dyja palët janë pajtuar se asnjëra nuk do t'ia bllokojë, dhe as nuk do të inkurajojë të tjerë që t'ia bllokojnë rrugën e palës tjetër në rrugëtimin përkatës drejt BE-së.

pak
progres

Përfundimisht, palët janë pajtuar që të themelojnë komisione të implementimit, me lehtësimin e BE-së. Krye-negociatori i secilit shtet kryeson komisionet respektive të implementimit. Ata do të mbikqyrin punën e komisioneve të implementimit gjatë përbaljes me secilën çështje specifike.

përfunduar

Që nga marrëveshja e prillit të vitit 2013, ka pasur progres në implementim por nuk është hapur asnjë temë e re.

Liria e lëvizjes dhe mallrat

Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, lëvizja e njerëzve dhe mallrave në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qenë e kufizuar, duke u vështirësuar edhe më shumë pas shpalljes së deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Megjithatë, gjendja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që prej nënshkrimit të marrëveshjeve të para në vitin 2011, edhe pse procedura e parashikuar në marrëveshje nuk ka qenë plotësisht funksionale deri në muajin maj të vitit 2013. Në shtator të vitit 2014 u hoqën edhe më shumë barrierat të lëvizjes së lirë, psh qytetarët e Kosovës tani mund të kalojnë tranzit nëpërmjet aeroportit Nikola Tesla të Beogradit. Trafiku hekurudhor dhe ajror mbesin ende për t'u diskutuar.

Prej vitit 1999, Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK-u) mori kontrollin mbi lëshimin e kartave personale të identitetit, dokumenteve të udhëtimit, targa¹⁸, si dhe të përfaqësimit të Kosovës në tregtinë ndërkombëtare. Kjo u komplikua më tej pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sepse kjo gjë nënkuptoi fundin e funksioneve administrative të UNMIK-ut në po atë muaj të korrikut. Serbia vazhdoi me lëshimin e dokumenteve të rëndësishme si pasaportat dhe targa. Kosova, si shtet i ri i pavarur, filloi lëshimin e dokumenteve të veta. Vulat doganore, në të cilat më herët shkruante "Doganat e UNMIK-ut", u bënë "Doganat e Kosovës", me ç'rast ato u bënë të papranueshme për Serbinë, dhe kjo rezultoi me një embargo

18 Këto targa kishin "KS", pra Kosovë, në pjesën e përparme.

për mallrat nga Kosova. As pasaportat e Kosovës, si një lloj simboli i shtetësisë, nuk u pranuan, andaj banorët e Kosovës nuk mund të hynin në Serbi përveç nëse kishin pasaportë jugosllave, serbe apo të ndonjë shteti tjetër.¹⁹ Drejtimi i makinës private ishte një tjetër problem, meqë Serbia nuk njihte patentën e shoferit të UNMIK-ut apo të Kosovës.

Kjo vazhdoi deri kur marrëveshja e korrikut të vitit 2011 mbi lirinë e lëvizjes i dha qytetarëve të Kosovës mundësinë për të udhëtuar për në Serbi me kartat të identitetit të Kosovës. Pas mbërritjes në territorin serb, ata duhet të marrin një dokument hyrjeje i cili lejon qëndrim deri në 90 ditë. I njëjti dokument paraqitet me rastin e daljes nga Serbia.

Më 4 shtator 2014, pas një viti negociatash, Serbia dhe Kosova u pajtuan në Bruksel për ndërtimin e objekteve të përhershme në vendkalimet kufitare.

Akoma nuk ka kurrfarë zgjidhje për njerëzit nga shtetet që nuk lëshojnë karta identiteti kombëtar, përveç nëse ata hyjnë në Serbi para se të hyjnë në Kosovë.²⁰ Zgjidhja e vetme është që ata të hyjnë në Serbi përmes një vendi të tretë si psh. Mali i Zi apo Maqedonia, duke zgjatur me këtë disa lloj udhëtime, si psh me makinë. Nëse ata hyjnë në Serbi para se të hyjnë në Kosovë, kanë 90 ditë në dispozicion për të ri-hyrë në Serbi me kusht që ata të mos kenë lëshuar Kosovën e të kenë ri-hyrë nga një tjetër vend kufitar.

Serbia vonoi implementimin e marrëveshjes për administrim të përbashkët të pikave kufitare deri në dhjetor të vitit 2012, por pikat e kontrollit tani janë në lokacione të përbashkëta dhe administrohen bashkarisht. Ato drejtohen nga zyrtarë nga Kosova dhe Serbia. EULEX-i monitoron dhe këshillon, por nuk është më aktiv në kryerjen e kontrollit të pasaportave ose atij doganor, gjë e cila ishte detyrë e rëndësishme në dy portat e veriut deri në mesin e vitit 2014. Një marrëveshje mbi shtrirjen e propozuar të pikave permanente të kalimit kufitar u arrit në shtator të vitit 2014. Megjithatë, në raportin e progresit 2014 për Serbinë, Komisioni Europian tha se Serbia duhet të bëjë më shumë për të penguar kalimin e paligjshëm të kufirit/vijës kufitare që shfrytëzojnë kontrabandistët.

Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Sistemit të Kartoniit të Gjelbërt, që do të lejonte pranimin e dyanshëm të sigurimit automotiv në shumicën e shteteve evropiane, pranimi i ndërsjellë i sigurimit është një çështje bilaterale në mes të Serbisë dhe Kosovës. Marrëveshja e IBM-it e vitit 2011 kishte vendosur parakusht që vozitësit që udhëtojnë në të dyja drejtimet do të duhet të paguajnë sigurime të shtrenjta në kufi.²¹

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2012, kur u implementua për herë të parë marrëveshja për sigurimin, trafiku i automjeteve për pasagjerë nga Serbia drejt Kosovës u përgjysmua, dhe banorët e Serbisë, posaçërisht shqiptarët etnikë të

19 Në raste të rralla, dokumentet e identifikimit të lëshuara nga UNMIK-u pranoheshin ndonjëherë në baza individuale.

20 Shtetasit e vendeve të mëposhtme nuk kanë karta të identitetit kombëtar: Australia, Kanada, Danimarka, Irlanda, India (shih më poshtë), Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

21 Qendra për Rajonalizim, Monitorimi i Implementimit të Marrëveshjes së arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fushën e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, Novi Sad, 2013.

nuk ka
progres

pak
progress

2011

Kadastrri

Njohja reciproke
e diplomave

IBM

2012



Përfaqësimi dhe
Bashkëpunimi Rajonal

2013

Gjyqësori



Telekomi

Asociacioni/
Komuniteti i
komunave serbe



Asnjëra nuk
do t'ia bllokojë

MARRËVESHJA
KOSOVË
SERBI

2011
2013
2013
2013

2011
2011
2013
2013

2011
2013
2013

2011
2011
2012
2013

pjesërisht e
përfunduar

përfunduar



Liria e lëvizjes

Vulat doganore



Regjistri civil



Policia dhe siguria



Diskutimet mbi
energjinë dhe
telekomin



Energjia



Themelimi i
komisionit të
implementimit



Zgjedhjet komunale

Viti	Nuk ka progress	Pak progress	Pjesërisht e përfunduar	Përfunduar
2011	1	2	1	2
2012		1		
2013	3	1	3	2
Totali	4	4	4	4

zonës jugore, deklaruan se kostoja e kësaj u ka shkëputur atyre lidhjet biznesore dhe familjare me Kosovën.²² Ata që hynin në Kosovë me tabela të Serbisë duhet të paguanin 20 Euro për një javë, 40 Euro për 15 ditë, apo 80 Euro për një muaj.²³ Ata që hynin nga shtetet tjera paguajnë 30 Euro për 15 ditë apo 41 Euro për një muaj.²⁴

Pas lobimit nga politikanët në jug të Serbisë, në tetor të vitit 2013, qeveria e Kosovës vendosi se do të paguante tarifat e sigurimit për shqiptarët etnikë që jetojnë në Preshevë, Medvexhë dhe Bujanoc²⁵ dhe të cilët duan të udhëtojnë në Kosovë, kjo pas lobimit nga ana e përfaqësuesve politikë të këtyre qarqeve.²⁶ Deri më tash, qeveria ka shpenzuar gati një milion Euro.

Vozitësit që hyjnë në Serbi me targa të Kosovës paguajnë 105 Euro sigurim mujor, e që është e vetmja tarifë dhe periudhë kohore në dispozicion. Kjo paraqet tarifë shumë të lartë marrë parasysh që paga mesatare mujore në Kosovë është afërsisht 436 Euro.²⁷ Atyre u duhet edhe të paguajnë për targa të përkohshme “PROBA”, të cilat kanë kosto shtesë prej 5 Euro për çdo ditë udhëtimi. Në pikën kufitare të Jarinjës, procesi i hyrjes në Serbi është mjaft i komplikuar. Kioska, e cila më herët ndodhej në pikën kufitare dhe shiste sigurime për personat që drejtonin automjetet me targa RKS, është mbyllur. Burime pranë kufirit, të cilat kanë dëshiruar të mbesin anonimë nga frika e humbjes së punës kanë thënë se qeveria e Serbisë nuk ka dashur që sigurimet të shiten në pikën kufitare.²⁸ Në vënd të kësaj, udhëtarët kosovarë duhet të parkojnë veturën në pikën kufitare, të ecin apo të ndalojnë ndonjë veturë dhe të shkojnë gati 1.5 kilometra larg për të paguar sigurimin, dhe pastaj të kthehen tek pika kufitare.

“Akoma nuk kemi liri të lëvizjes, dhe kjo është sfidë për autoritetet sepse nëse ka ndonjë pacient që sëmuret, e që ka nevojë të dërgohet diku, duhet të paguajë, ose me para, ose me jetë”, thotë Selatini nga Kaçaniku, drejtor i OJQ-së “Consumer”.

Ka komplikime të shumta për organizim të skemave të sigurimeve që do të pranoheshin reciprokisht, meqë shumica e kompanive të sigurimit janë kompani nën pronësi private që qeveria thotë se nuk mund t’i rregullojë.

“Nuk ka kurrfarë marrëveshje të cilën mund ta bëjmë ne që të mund të detyronte kompanitë private të ndryshojnë normat e tyre... Lobi i kompanive të sigurimeve është i fuqishëm, dhe shumica janë kompani të huaja”, thotë Borko Stefanovic, i cili ka negociuar marrëveshjen për Liri të Lëvizjes për palën

22 http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/blogreview/2012/04/28/blog-03

23 Shih çmimoren e Byrosë së Sigurimeve të Kosovës: <http://www.bks-ks.org/static/uploads/publications/tarifaf/tarifa0.png>

24 Shih çmimoren e Byrosë së Sigurimeve të Kosovës: <http://www.bks-ks.org/static/uploads/publications/tarifaf/tarifa1.png>

25 Vendimi 02/151 i Qeverisë së Kosovës i datës 11 tetor 2013.

26 Qeveria e Kosovës shpenzoi 315,000 Euro në mbulim të tarifave në vitin 2013, dhe deri tani, pra në vitin 2014 ka shpenzuar 620,000 euro, sipas një zëdhënësi të Ministrisë së Financave.

27 Paga mesatare për qytetarët e Kosovës në shtator të vitit 2014, siç raportohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

28 Vizitë e BigDeal në Jarinjë në tetor 2014.

serbe.²⁹ “Krejt çka mund të bëjmë ne është t’i lejojmë njerëzit të hyjnë”. Megjithatë, ai thekson se qeveria ka hise në emërimin e drejtorëve të kompanisë shtetërore të sigurimit, Dunav.

“Ekzistojnë disa rregulla ndërkombëtare të lojës, kur është fjala për sigurimin, dhe shteti është kontrolluesi i fundit i cili përcakton mënyrën e funksionimit të kompanive të sigurimit”, tha Marko Djuric për BigDeal. “Sigurisht që është obligim i yni që të udhëhiqemi nga interesat e popullit dhe jo interesat e çfarëdo biznesi dhe ne do të jemi konsistent deri në fund”.³⁰

Këshilli i Byrove, organizata menaxhuese e Kartonit të Gjelbër shumëpalësh, e cila përdoret në shumicën e Europës, është pajtuar që të shërbejë si ndërmjetës në bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë për njohjen e ndërsjellë të sigurimit, por disa mosmarrëveshje lidhur me thelbin e zgjidhjes vazhdojnë të jenë të pranishme.³¹

Më 7 tetor 2014, Vlora Obërtinca, drejtoresha e Departamentit të Kartonit të Gjelbër në Byronë e Kosovës, premtoi se çështja do të zgjidhet brenda disa muajve.

“Kosova do të pranohet dhe do të lehtësojë çështjen e barrierave të eksportit dhe do t’i lehtësohet lëshimi i kartonit të gjelbër nga një prej shteteve të besueshme të Europës Perëndimore»³², tha ajo.

Në një intervistë, zëvendës-kryeministrja Tahiri tha për BigDeal, se deri në janar të vitit 2015 do të përgatiten aranzhime për çmime më të ulëta të sigurimit.³³

Udhëtimi Ajror dhe Tranzit: Më 16 shtator 2014, të dyja palët u pajtuan që të lejojnë kosovarët të udhëtojnë përmes Serbisë për në pika tjera tranzite për në Bullgari dhe Maqedoni, (përveç pikave ekzistuese për në Kroaci dhe Hungari), duke hyrë në fuqi më 16 nëntor.³⁴ Kjo gjithashtu i dha qytetarëve të Kosovës të drejtën që të fluturojnë përmes aeroportit ndërkombëtar të Beogradit me kartë identiteti, duke filluar nga data 22 shtator. Eventualisht, atyre do t’u lejohet edhe fluturimi nga aeroporti i Nishit.

Në tetor, një anëtar i ekipit të BigDeal ateroi në aeroportin Nikola Tesla të Beogradit dhe u nis për në Podgoricë të Malit të Zi me kartë identiteti të Kosovës, duke konfirmuar kështu që kjo politikë është zbatuar.

Udhëtimi me tren: Ekziston edhe një çështje tjetër që lidhet me lirinë e lëvizjes, por ajo nuk është ngritur gjatë dialogut në Bruksel, dhe ajo çështje është e trenit të Serbisë, i cili që nga tetori i vitit 2013, udhëton nga Mitrovica e veriut në Kraljevë, dhe lidhet me Beograd dhe më gjerë.

“Ky tren është jashtë kontrollit të autoriteteve hekurudhore të Kosovës”, tha për BigDeal zëvendës-kryeministrja Tahiri.³⁵

²⁹ Intervistë me Borko Stefanovic 23 shtator 2014.

³⁰ Intervistë me Marko Djuric 25 shtator 2014.

³¹ Shih Raportin e tetorit 2014 të Qeverisë së Kosovës mbi ecurinë e gjendjes, faqe 25.

³² Deklaratë e Vlora Obërtincës më 7 tetor 2014 në Prishtinë.

³³ Intervistë me zëvendës-kryeministren Tahiri në Prishtinë më 21 tetor 2014.

³⁴ Pikat kufitare janë Kelebia (PKK i Serbisë me Hungarinë), Gradina (PKK i Serbisë me Bullgarinë), Presheva (PKK i Serbisë me Maqedoninë)

³⁵ Deklaratë për Prishtina Insight në mars 2014. Për më shumë, shih <http://www.balkaninsight.com/en/article/train-to-serbia-leaves-kosovo-steaming>

Nga viti 2000-2008, hekurudhat e UNMIK-ut kanë drejtuar të gjitha linjat hekurudhore në tërë Kosovën. Hekurudhat e Kosovës morën në dorë autoritetin nga UNMIK-u në vitin 2008. Megjithatë, në mars të vitit 2008, Serbia "rimori" nën kontroll linjën mbi 50 kilometërshë Leshak-Zveçan. Treni nga Serbia për në Zveçan ka filluar drejtimin në qershor të vitit 2008. Shërbimi përfshiu Mitrovicën e Veriut në muajin tetor 2013.

Udhëheqësit e kompanive kosovare të trenave, Trainkos dhe InfraKos, thonë se nuk kanë marrë asnjë pagesë nga Hekurudhat e Serbisë për shfrytëzimin e pronës së tyre, gjegjësisht të hekurudhave.

"Ata nuk na paguajnë asnjë para; ky është një lloj okupimi ilegal, madje, një lloj pushtimi", tha për BigDeal drejtuesi i sindikatës së Hekurudhave të Kosovës, Sabet Thaçi.³⁶

Dogana dhe tregtia e lirë

Serbia dhe Kosova kanë arritur marrëveshje mbi vulat doganore më datë 2 shtator 2011, ndërsa implementimi ka filluar nga të dyja palët në fund të po të njëjtit muaj. Marrëveshja është bazuar në parimet e Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), e cila paraqet marrëveshje mes shteteve jo-anëtare të BE-së në Europën juglindore. Kjo marrëveshje largoi embargon tre-vjeçare të Serbisë ndaj mallrave të Kosovës.

Marrëveshja fillimisht u implementua në katër pikat e kalimit kufitar, ndërkohë që kishte barrikada/bllokada rruge që pengonin rrjedhën e mallrave në pikën e kalimit verior në Jarinjë dhe Bërnjak. Kjo parahati çoi në një kundër-embargo të Kosovës për mallrat e Serbisë. Kjo gjendje e pakalueshme u zgjidh përmes marrëveshjes IBM të dhjetorit të vitit 2011, e cila planifikonte të vendoste zyrtarë doganorë të të dy vendeve në një kulm. Është duke u realizuar ngadatë, por pati një moment revolucionar me rastin e marrëveshjes së shtatorit 2014 mbi pilot-dizajnet për ndërtimin permanent të pikave me lokacion të përbashkët.

Më datë 17 janar 2013, të dy palët u pajtuan rreth marrëveshjes për arkëtim të të hyrave doganore në Jarinjë dhe Bërnjak, për arkëtim të parave të cilat do të shkonin në një fond të veçantë për zhvillimin e komunave veriore. Ky arkëtim filloi pa incident më datë 14 dhjetor 2013. EULEX-i vazhdon prezencën në kufi, dhe nuk ka pasur ndonjë problem madhor, sipas zyrtarëve doganorë të Kosovës. Autoritetet e Kosovës arkëtojnë akcizë të aplikueshme që përfshin TVSH. Një zëdhënës i BE-së ka thënë për BigDeal se deri kah mesi i shtatorit, më shumë se 3 milion Euro janë inkasuar për atë fond.³⁷

Si rezultat i marrëveshjeve, tregtia mes dy vendeve është rritur drastikisht, në pajtim me marrëveshjen për doganat. Sipas Adriatik Stavilecit, zëdhënës i Agjencisë Doganore, eksportet e Kosovës në Serbi janë rritur krahasuar me vitin e kaluar. Statistikat kanë treguar rritje prej 185%, nga 7.7 milionë në vitin 2013 nëafërsisht 22.5 milionë në vitin 2014.³⁸

36 Intervistë me Sabet Thaçin në Fushë Kosovë në mars 2014.

37 Intervistë me Përfaqësuesin Special të BE-së Samuel Zhbogar në shtator 2014.

38 Intervistë me Stavilecin në shtator 2014.

Përkundër rritjes së volumit të tregtisë, vazhdon të ekzistojë mosbalancë tregtare. Importet nga Serbia në Kosovë vlerësohen rreth 255.6 milionë në vitin 2010 dhe 280 milionë në vitin 2013, sipas Stavitecit, ndërsa që vlerësimet e Serbisë janë më të larta, rreth 300 milionë.³⁹

Ka pasur sfida të mëdha byrokratike lidhur me atë se si saktësisht duhet të implementohet marrëveshja e tregtisë së lirë, sipas fjalëve të zyrtarëve komunalë në Mitrovicë të cilët regjistrojnë kompani në Serbi. Sipas interpretimit fillestar të marrëveshjes, kompanitë e Serbisë që veçse operonin në veri të Kosovës nuk kishin nevojë të ri-regjistrohen, me kusht që ato kanë qenë duke funksionuar para datës 19 prill 2013. Megjithatë, agjencia doganore e Kosovës ka këmbëngulur që të gjitha kompanitë të ri-regjistrohen përmes një procesi të ngadaltë e delikat, për të cilin një zyrtar i Kosovës thotë se nuk është në frymën e marrëveshjes.⁴⁰

Fondi Zhvillimor për veriun e Kosovës u themelua më datë 13 dhjetor 2013, një ditë para se të fillojë arkëtimin doganor në Jarinjë dhe Bërnjak. Paratë doganore të arkëtuara nga “kompanitë operuese dhe mallrat e destinuar për popullatën e komunave të veriut” duhet t’i transferohen Fondit Zhvillimor, siç parasheh ligji i Kosovës.

Krijimi i këtij fondi – si përgjegjësi e Kosovës – nuk ndodhi me kohë. Marrëveshja për arkëtimin doganor u arrit në Bruksel më datë 17 janar 2013, dhe ajo ishte vetë thirrja për krijimin e një fondi brenda shtatë ditësh të parapara në marrëveshje. Megjithatë, pati disa probleme rreth përcaktimit të kornizës ligjore për atë fond, dhe e vetmja zgjidhje ishte që fondi të inkorporohet në rishikimin buxhetor në gjysmën e vitit të cilin e bën Kuvendi i Kosovës.⁴¹ Ligji mbi buxhetin, duke përfshirë edhe dispozitat për fondin zhvillimor, u miratua më datë 25 korrik 2013 dhe u nënshkrua nga presidentja më 2 shtator 2013, mirëpo, sipas zëvendës-kryeministres Edita Tahiri, “nuk është bërë asnjë gjë përgatitore në ndërkohë”. Sipas raportit të qeverisë së Kosovës, zyrtarët e BE-së kanë identifikuar se është më e udhës që të pritet deri pas zgjedhjeve lokale të nëntorit 2013 që të fillohet me arkëtimin doganor.

Bordi tre-anëtarësh përgjegjës për përcaktimin e projekteve është i përbërë nga Përfaqësuesi Special i BE-së, Samuel Zhbogar, Ministri i Financave i Kosovës, Besim Beqaj, dhe përfaqësuesja serbe, Danijela Zubac. Bordi tek duhet të marrë vendim rreth shfrytëzimit të këtyre parave.

Sa i përket marrëveshjes, “Fondi Zhvillimor mund të rritet edhe me anë të kontributeve shtesë nga donatorët, në pajtim me legjislacionin e Kosovës”, mirëpo deri tash, asnjë para përveç të hyrave nga arkëtimi doganor nuk i është shtuar këtij fondi.

39 Qendra për Rajonalizim, Monitorimi i Implementimit të Marrëveshjes së arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fushën e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, Novi Sad, 2013.

40 Intervistë me zyrtar të Kosovës në Mitrovicë të veriut në shtator 2014.

41 Raporti i ecursionit të gjendjes i publikuar në janar 2014.

Ndryshimet që kanë ndikim tek serbët e Kosovës, veçanërisht në komunat veriore

Si pjesë e marrëveshjes së Brukselit, Serbia ka premtuar se do të shpërbëjë strukturat qeverisëse në territorin e Kosovës, dhe se katër komunat veriore do të krijohen brenda ligjit të Kosovës. Serbët nga veriu dhe pjesa tjetër e Kosovës do të fitonin autonomi në arsim, kulturë, shëndetësi dhe planifikim urban. Këto detyra do të mbikëqyreshin nga Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe. Këto aranzhime të reja do t'i japin serbëve të Kosovës – dhe vetë Beogradit – pushtet të paprecedent në nivel nacional, ndërsa që niveli i autonomisë që do t'i jepet Asociacionit/Komunitetit vazhdon të jetë temë e nxehtë debati. Gjersa fakti se 400 policë serbë të Kosovës që iu bashkuan radhëve të Policisë së Kosovës është diçka për t'u lëvdur, mos formimi i Asociacionit të Komunave që parashihet me marrëveshje, si dhe mungesa e gjyqësorit funksional – paraqesin pengesa për stabilitet.

Strukturat paralele

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, qeveria e Serbisë vazhdoi të veprojë nëpër tërë Kosovën. Ajo akoma paguan punonjës për tërë territorin e Kosovës, me anë të organeve të quajtura “privremeno vece”, apo “këshillet e përkohshme”. Sipas hulumtimeve të gazetarëve të Serbisë, në total ka më shumë se 5,100 njerëz të zgjedhur apo të emëruar në listën e pagave të Serbisë të cilët punojnë në pushtetin lokal apo në ndërmarrje publike, duke përfshirë edhe shkollat dhe spitalet në territorin e Kosovës, në 29 komuna. Prishtina ka më së shumti punonjës, 840, ndërsa Mitrovica veriore ka 614, Leposaviqi 510, Zubin Potoku 399, dhe Zveçani 242.42 Disa prej këtyre njerëzve zyrtarisht punojnë në institucionet e Kosovës dhe marrin dy paga. Të tjerë nuk kanë vend pune ku të shkojnë apo punë për të bërë, por vazhdojnë të marrin pagat.

Në vitin 2012 dhe 2013, qeveria serbe shpenzoi 634 milionë Euro në Kosovë, që paraqet një mesatare prej 867.000 Euro në ditë.⁴³ Qeveria e Kosovës i quan këto “struktura paralele”. Kjo paraqet terminologjinë e përbashkët me të cilën u referohet institucioneve që financohen nga Serbia në Kosovë, por në fjalorin e përditshëm përdoret në mënyra tjera. Ky term shpesh përdoret për t'iu referuar “Civilna Zastita-s”, apo njësisve të Mbrojtjes Civile që veprojnë në komunat veriore, të cilat Kosova dhe Bashkimi Europian duan t'i shohin të shpërbëra dhe personelin e tyre ta përfshijnë në institucionet përkatëse të Kosovës.

Më gjerësisht, ky term i referohet thjeshtë institucioneve, si shkollat, spitalet apo komunat, të cilat ofrojnë shërbime për serbët që jetojnë në Kosovë. “Nuk mund t'i quani ‘institucione paralele’ ato”, thotë një zyrtar komunal në Mitrovicë,

“Me mbështetjen e Prishtinës, Beogradi ka fituar përfaqësim më të fortë në Kosovë në nivel nacional.”

—NJË ZYRTAR
I KOSOVËS, QË
SHËRBEN NË
QEVERISJE LOKALE

42 Të dhënat e ofruara nga Ivan Angelovski, nga transmetuesi serb B92, emisioni Insajder. Pagat për këta 5,106 njerëz i kushtojnë qeverisë së Serbisë afro 2,175,000 Euro në muaj.

43 Sipas hetimeve të gazetarëve të emisionit Insajder nga B92 shumica e këtyre parave janë humbur nga korrupsioni. Një Komision Hetimor i mandatuar nga parlamenti serb për të hetuar akuzat për korrupsion nga viti 2000-2012 publikoi një raport në prill 2014 duke arritur në përfundimin se vendimi i qeverisë serbe i vitit 2005 për të hequr TVSH-në për mallrat që shkojnë në Kosovë, çoi në lulëzim të krimit të organizuar, duke destabilizuar veriu e Kosovës.

“sepse, këto janë të vetmet institucione që ofrojnë shërbimet të cilat u nevojiten njerëzve”.⁴⁴

Në shumë raste, pa fonde nga qeveria e Serbisë, disa shërbime të rëndësishme që ofrohen për njerëzit që jetojnë në Kosovë do të pushonin së funksionuari. Për shembull, janë rreth 1,560 punonjës që punojnë në spitalin verior të Mitrovicës, sipas një zyrtari lokal komunal. Qeveria e Kosovës siguron fonde për rreth 225 rroga,⁴⁵ ndërsa qeveria e Serbisë jep pjesën tjetër të parave. Ndonëse spitalit mund të mos i duhen gjithë ata 1,560 të punësuar për të qenë plotësisht funksional, i duhen të paktën 1000, siç vlerëson zyrtari në fjalë, andaj 225 është gjithsesi shumë pak.⁴⁶ E njëjta gjë mund të thuhet edhe për institucionet e tjera: ato janë të fryra me para serbe, por qeveria e Kosovës akoma nuk ka kryer pothuaj as edhe një pjesë më të vogël të parave të nevojshme për të financuar buxhetet e këtyre institucioneve.

Si pjesë e Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, Serbia u zotua që të shpërbëjë katër komunat paralele që i përgjigjen Beogradit dhe të mbajë zgjedhjet për pushtetin lokal brenda Kosovës.

Zgjedhjet

Më datë 3 nëntor 2013, komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës mbajtën zgjedhjet e para nën administrimin e Prishtinës pas pavarësisë së Kosovës, me lehtësimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Kjo ndodhi përkundër njëfarë klime frikësimi e madje edhe dhune në veri të Mitrovicës, nga ana e kundërshtuesve të ashpër të marrëveshjes dhe detyrimit për të votuar të transmetuar nga Beogradi. Komunat më pas miratuan statutet komunale dhe filluan të funksionojnë në kuadër të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, edhe pse ato do të gëzojnë një shkallë autonomie, kur të formohet Asociacioni i komunave me shumicë serbe.

Klima nën të cilat u mbajtën zgjedhjet ishte e tensionuar, posaçërisht në pjesën veriore të Mitrovicës, ku një varg i zgjatuar prej katër zgjedhjesh u shoqëruan së pari nga dhuna, e pastaj me vrasjen e një kandidati për kryetar komune dhe arrestimin e një tjetri për krime lufte.

Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dalja në zgjedhje ishte 22 përqind në Leposaviq dhe Zubin Potok, ndërsa 11.21 përqind në Zveçan, pjesëmarrje shumë e ulët krahasuar me mesataren prej rreth 40 përqind në mbarë Kosovën. Iniciativa Qytetare serbe, e njohur me shkurtesën GIS nga emri i saj në serbisht Gradjanska Inicijativa Srpska (e njohur më shumë si Srpska Lista), fitoi nëntë nga dhjetë komuna me shumicë serbe (përfshirë bën Shtërpca). GIS-i, i cili bëri bashkë shumicën e partive politike të serbëve të Kosovës, paraqet listën e preferuar haptazi nga Beogradi dhe fitorja e GIS-it do të thotë se Beogradi mund të ushtrojë ndikim mbi zyrtarët sa i përket implementimit të marrëveshjes, kurdo

⁴⁴ Intervistë në shtator 2014 me një zyrtar komunal të nivelit të lartë.

⁴⁵ Në raste si ky, punonjësi merr një pagë nga qeveria e Serbisë, kështu që 225 punonjësit kanë paga të dyfishta.

⁴⁶ Intervistë me zyrtar komunal në Mitrovicë të Veriut.

që të dëshirojë. Në Shtërpcë, Srpska Samostalna Stranka (SLS), e cila ishte në koalicion me PDK-në e Taçiçit, mbajti kontrollin e komunës.

Në veri mungonte siguria. Në pjesën veriore të Mitrovicës, njerëz të maskuar sulmuan tre vendvotime para mbrëmjes. OSBE-ja tërhoqi vëzhguesit e saj, mbylli para kohe qendrat e votimit, dhe anuloi të gjitha rezultatet. Dy gazetarë serbë, një nga Kosova dhe një tjetër nga Serbia, si dhe një deputet serb thanë për BigDeal se njerëzit e maskuar që hynë në tre vendvotimet në veri të Mitrovicës, ishin pjesëtarë të xhandarmërisë serbe, të cilët donin që t'i parandalonin fitoren në zgjedhje një shqiptari, Agim Devës, që do të vinte si rezultat i daljes së ulët të serbëve në zgjedhje, dhe prandaj synuan ta dëmtojnë votimin.

Më 17 nëntor, në tri qendra të votimit zgjedhjet u zhvilluan sërish. Të gjitha forcat e sigurisë ishin të pranishme: Policia e Kosovës, EULEX-i, KFOR-i, si dhe forcat e sigurisë serbe dhe civilna zastita, apo mbrojtja civile. Në pjesën veriore të Mitrovicës, zgjedhjet u mbajtën për herë të tretë. Askush nuk doli fitimtar nga vota e 17 nëntorit, dhe balotazhi i datës 1 dhjetor caktoi Krstimir Pantiçin në krye me 55 për qind të gjithsej 5,000 votave. Megjithatë, Pantiç refuzoi të nënshkruajë betimin i cili kishte ëmblemën e Kosovës, duke thënë se me këtë ai do të shkelte kushtetutën e Serbisë. Një kandidat i cili do të mund ta zëvendësonte atë, Dimitrije Janiçiçević, u qëllua për vdekje para apartamentit të tij më datë 16 janar.⁴⁷ Janiçiçević, anëtar i partisë Liberale Serbe, SLS, e cila ishte pjesë e koalicionit qeveritar në Prishtinë, kishte humbur zgjedhjet nga Pantiç, por ai megjithatë mund të zgjidhej. Një javë më vonë, Oliver Ivanoviç, një tjetër konkurrent kryesor për kryetar komune u arrestua nga EULEX-i me dyshime për krime të luftës. Ai u padit në muajin gusht.⁴⁸ Vrasja e Janiçiçevićit dhe arrestimi i Ivanoviçit shtoi ndjenjën e frikës si dhe shtoi parandjenjën para raundit të katërt të zgjedhjeve që u mbajtën më 23 shkurt. Fitoi kandidati i favorizuar nga Beogradi, ish-zjarrfikësi Goran Rakiç.

Një numër banorësh të Mitrovicës së Veriut ishin kritikë ndaj përzgjedhjes së kandidatëve të cilët qëndruan në votim dhe ndaj presionimit të votuesve.

“Njerëzit u detyruan të dalin e të votojnë, kjo nuk është demokratike”, tha për BigDeal një qytetar i Mitrovicës së Veriut që nuk desh të dihet me emër. “Punorjësia e shkollave dhe kompanive publike u vunë nën presion për të votuar... njerëzit kanë humbur besimin në demokraci».⁴⁹

Petar Miletiç, ish zëvendës-kryetar i parlamentit të Kosovës si dhe themeluesi i SLS-Partisë së Pavarur Liberale, e cila ishte në koalicion me PDK-në në qeverinë e kaluar, pajtohet me këtë.

“Udhëheqësia e serbëve të Kosovës duhet të vijë nga zgjedhjet – e këto nuk ishin zgjedhje të vërteta, ata që u përzgjedhën në emër tonin nuk u zgjedhën, ata u emëruan nga Beogradi”, tha ai për BigDeal. “Nuk ka elitë politike serbe në veri të Kosovës. Ata pesë deputetët nga veriu, askush nuk i njeh, dhe kryetarët e komunave janë politikisht të dobët. E vetmja gjë e pozitive është se ekstremistët

47 <http://uk.reuters.com/article/2014/01/16/uk-kosovo-murder-idUKBREA0F0RZ20140116>

48 <http://www.bbc.com/news/world-europe-25933153>

49 Intervistë në shtator 2014 në Mitrovicë të Veriut

janë marginalizuar”.⁵⁰

Pas vështirësive me zgjedhjet, komunat qenë të ngadalshme për të filluar funksionimin, dhe çdo gjë u bë në minutë të fundit, por që të katërtat u futën zyrtarisht brenda ligjit të Kosovës. Më datë 11 janar 2014, në mbrëmje, që ishte afati ligjor që kuvendet komunale të mbajnë seancat inauguruese, kryetarët dhe këshilltarët nënshkruan betimin e tyre vetëm pasi që ngjiteset me shenjë të BE-së mbuluan shenjën e Kosovës. 10 shkurti ishte afati ligjor për zgjedhjen e ulëseve të kuvendeve komunale, të cilët u votuan vetëm pak orë para fundit. Burimet e BigDeal thanë se disa zyrtarë komunalë nuk ishin shumë të etur që të marrin kartat e identitetit të Kosovës, por në fund e bënë këtë gjë në mënyrë që të marrin pagat. Në Mitrovicë, kuvendi komunal sërish priti deri në ditën e fundit për të vendosur statutin e saj komunal, më datë 15 maj, dhe për pak sa nuk pati nevojë për një raund tjetër të zgjedhjeve. Statuti u zgjidh përfundimisht me ndihmë rigoroze ndërmjetësuese Amerikane dhe Europiane. Nevoja për ndërhyrje të vazhdueshme ndërkombëtare është shqetësuese.

Partitë serbe nuk ishin të sigurt nëse do të merrnin pjesë apo jo në zgjedhjet e përgjithshme të 8 qershorit 2014, të cilat do të shënonin herën e parë të pjesëmarrjes së serbëve të veriut. Vetëm dy ditë përpara votimit, serbët ranë dakord që të marrin pjesë, duke rezultuar kështu me periudhë shumë të shkurtër fushate. Akuza rreth frikësimit të votuesve dhe kushtëzimit nga ana e ndërmarrjeve publike për votë janë të shumta.⁵¹

Për t'i hapur rrugën emërimit të kryetarëve të komunave, oficerëve të policisë, si dhe zyrtarëve tjerë serbë brenda sistemit të Kosovës, Kosova u pajtua në Bruksel që të miratojë ligjin mbi amnistinë. Qëllimi paraprak ishte që të garantohej se ata që janë fajtorë për krimet jo të rënda të kryera me rastin e turbullirave kundër qeverisë së Prishtinës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës – nuk do të ndiqen penalisht. Serbia tha se nuk do të shpërbëjë strukturat e saj paralele derisa të miratohet ligji. Versioni origjinal i ligjit të hartuar nga qeveria, që iu përcjell Parlamentit të Kosovës në qershor 2013 ishte më gjithëpërfshirës sesa që kishte kërkuar Brukseli: ligji përfshinte krimet e kryera në tërë Kosovën dhe jo vetëm në komunat veriore. Shkeljet që do të faleshin përfshinin zjarrvënien, nxitjen e urrejtjes etno-nacionale, racore ose fetare, spiunazhin, kryengritjen e armatosur, posedimin e armëve të paligjshme dhe rrezikimin e integritetit territorial të Kosovës.⁵²

Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin më datë 11 korrik 2013⁵³, me 90 vota pro nga gjithsej 120 deputetë, por në Kuvend pati kundërshtime substanciale si edhe brenda aktivistëve të shoqërisë civile të cilët kundërshtonin ligjin, sepse ata e konsideronin këtë ligj si shumë tolerues. Kundërshtuesit e ligjit mblodhën gati 13,000

⁵⁰ Intervistë me Miletić-in në Graçanicë në tetor 2014.

⁵¹ Gjatë një interviste, gjyshes së një të intervistuarit, që ishte e sëmurë dhe e shtrirë në krevat i ishte thënë se duhet të dilte në votim në mënyrë që të merrte pensionin. BIG DEAL personalisht pa mesazhin telefonit nga shtëpia publike e pleqëve në ditën e zgjedhjeve, më 8 qershor 2014.

⁵² <http://www.reuters.com/article/2013/07/11/us-kosovo-serbia-amnesty-idUSBRE96AOP120130711>

⁵³ Projektligji për Amnistinë. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Ligjet/04-L-209.pdf>

nënshkrime përmes një peticioni me të cilin i kërkonin presidentes që të mos nënshkruajë ligjin. Lëvizja Vetëvendosje kundërshtoi ashpër ligjin dhe e dërgoi atë në gjykatën kushtetuese. Megjithatë, ligji u nënshkrua nga Presidentja më 19 shtator 2013, pasi që Gjykata Kushtetuese e Kosovës ndryshoi ligjin, ku e cila kërkoi që nenet që parashikonin amnisti për shkatërrim prone, ndihmim të kundërvajtjes, dhe falsifikim dokumentesh të hiqeshin nga ligji. Ligji u bë ligj lejues, duke ofruar amnisti për më shumë se sa që synonte marrëveshja e Brukselit. Analiza e fundit nga gazeta ditore kosovare Koha Ditore, zbuloi se 1,237 njerëz kanë përfutuar nga ky ligj: 1000 shqiptarë, 216 serbë dhe 21 boshnjakë.⁵⁴

Asociacioni i komunave

Ndonëse Serbia njeh rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë, si dhe mbështet kandidatët që fituan, ajo vazhdon të financojë komunitatet e vjetra nëpërmjet “këshillave të përkohshme qeverisëse”, dhe madje politikanët e Srpska Lista-s të zgjedhur në veri kanë edhe pozita në qeverinë e Serbisë. Lideri i Srpska Lista-s është Aleksandar Jablanović, i cili është zëvendës kryetar i kuvendit të Serbisë nga radhët e partisë socialiste, e cila udhëhiqet nga Ministri i Punës, Aleksandar Vulin, ish kreu Serb i zyrës për Kosovë. Të gjitha palët pajtohen që këto struktura do të shpërbëhen pasi të formohet Asociacioni i Komunave Serbe.

Asociacioni ka qenë burim mospajtimesh mes Beogradit dhe Prishtinës. Në nëntor të vitit 2013, një nga sloganet që përdorte Srpska Lista ishte “Më 3 Nëntor: Voto Srpska-n, më 4 nëntor, ndërto Srpska-n”.⁵⁵ Kjo e fundit Srpska, i referohet fuqimisht entitetit Republika Srpska të Bosnjës, e cila ka autonomi substanciale në Bosnjë e Hercegovinë dhe lideri i së cilës, Milorad Dodik, kërcënohet shpesh se do të shkëputet nga Bosnjë e Hercegovina. Në anën tjetër, Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi ka thënë se Asociacioni do të kishte funksionin më shumë si OJQ .

Mospërputhja e pikëpamjeve dhe e shtypit lidhur me Asociacionin do të çojë në zhgënjime të paevitueshme, thotë Miletiç.

“Ky lloj bisedimesh rrit pritjet e të dyja anëve, gjë e cila mund të ketë pasoja negative,” ka thënë ai për BigDeal.⁵⁶

Plani i implementimit i rënë dakord në maj të vitit 2013 ka paraparë krijimin e një ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të komunave serbe deri në fund të muajit maj, ndërsa vetë themelimin e asociacionit deri në mes të muajit dhjetor. Kah mesi i qershorit të vitit 2013, të dy qeveritë u pajtuan për atë se kush do të jetë pjesë e ekipit menaxhues të Asociacionit, katër serbë të veriut: Igor Kalamar, Dragan Jablanović, Ljubomir Mariç, dhe Dejan Radojković.

Plani i implementimit ka paraparë themelimin e AKS (Asociacioni i komunave serbe) dhe dërgimin e Statutit të tij për miratim në Kuvendin e Kosovës, deri në fund të tetorit të vitit 2013. Pati vonesa të shumta në zgjedhjen e përfaqësuesve

⁵⁴ Shih “Ligji i amnistisë jep rezultate”, Koha Ditore, 9 shtator 2014. <http://koha.net/?id=27&l=25058>

⁵⁵ Dëgjo shpalljen në faqen e Radio Graçanicës në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=07BfG3LUhsY>

⁵⁶ Intervistë me Miletiç-in në Graçanicë në 2014.

komunalë dhe në vetë themelimin e komunave. Si rezultat, AKS nuk u konstituua. Duke përdorur modelin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (MAPL)⁵⁷ qeveria në Prishtinë zhvilloi një pilot-statut dhe e prezantoi atë në Bruksel në dhjetor. Ajo u diskutua në takimin e dy kryeministrave më datë 27 janar 2014, që ishte takimi i parë pasi që komunat më në fund u themeluan. Megjithatë, pilot-statuti i propozuar nga MAPL e Kosovës nuk u pranua nga Beogradi dhe AKS nuk ishte në agjendën e takimeve të mëvonshme.

Sipas një zyrtari të BE-së, ka shqetësime për atë se serbët mund të thonë se çfarëdo që nuk është e definuar në mënyrë eksplicite në statut është kompetencë e AKS-së. Megjithatë, për shkak të natyrës së dakorduar për AKS-në – arsimi, shëndetësia, kultura, dhe planifikimi komunal – nuk ka gjasë që ai të merr fuqi veto-je për të bllokuar vendimet në nivel qendror të shtetit.

AKS mund t'i paraqesë disa gracka qeverisë qendrore të Kosovës. Ajo me gjasë do të ketë qasje në financim të konsiderueshëm, meqë ajo mund të jetë depoja kryesore për fonde nga Serbia dhe Bashkimi Europian. Kjo me gjasë do të zvogëlonte rolin e Prishtinës në qeverisjen e veriut. Autorët e një raporti të shkurtër të Institutit të Politikës Qendrore Europiane vunë në dukje se «Në qoftë se AKS merr të gjitha fondet që i duhen nga Beogradi dhe nga BE-ja, atëherë serbët e veriut të Kosovës do të kenë fare pak stimulim që t'i drejtohen Prishtinës».⁵⁸

Megjithatë, zyrtarët në komunat veriore ishin skeptikë për derdhjen e fondeve të premtuara nga BE-ja, dhe ngritën disa shqetësime lidhur me korrupsion të mundshëm në ndarjen e kontratave dhe pagesën e fondeve të caktuara enkas për veriun.⁵⁹

Përfshirja e gjashtë komunave me shumicë serbe në pjesën jugore, të cilat tashmë pak a shumë janë inkorporuar me sukses në institucionet e Kosovës dhe kanë lidhje me Prishtinën, do të mund të mbante AKS-në të rënjosur në Kosovë, në vend se kjo të ngjallte ndjenjën e një entiteti krejtësisht të veçantë.

Ndërkohë, tensionet në veri mund të shperthejnë me shpejtësi, sidomos në Mitrovicë. Vetëm dy javë pas zgjedhjeve nacionale të Kosovës, më datë 18 qershor 2014 banorët e vendit u zgjuan me lajmin se barrikada tre vjeçare në anën veriore të “Urës së Re” të Mitrovicës, që ndan veriun kryesisht serb nga jugu kryesisht shqiptar, ishin hequr. Është e paqartë se kush kishte urdhëruar heqjen e barrikadave, por qytetarëve nuk u ishte thënë ndonjë gjë lidhur me këtë më parë, edhe pse ka indikacione se zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë të nivelit të lartë dinin paraprakisht lidhur me këtë.⁶⁰

“Kjo gjë po pritej. Kam punuar ngushtë me diplomatë të huaj, por edhe me njerëz nga veri i qytetit. Unë mbajta premtimin tim, meqë siç mund të shihni, barrikada po hiqet”, tha kryetari i komunës së Mitrovicës jugore, Agim Bahtiri.⁶¹

57 Asociacioni i Komunave të Kosovës përbëhet nga të gjitha komunat në jug të Kosovës. Qëllimi i tij është të promovojë decentralizimin e pushtetit si dhe nxitjen e partneritetit mes qeverisë lokale dhe nacionale. Kreu i saj zgjedhet me rotacion.

58 “Integrimit apo Izolimit? Kosova Veriore në vitin 2014 në harresë zgjedhore”. Leon Malazogu, Milan Niç, Filip Ejdu dhe Tomasz Zornaczuk për Institutin e Politikave Qendrore Europiane, 13 shkurt 2014

59 Vizitë në Zyrën Administrative të Mitrovicës së veriut në shtator 2014.

60 Intervistë me zyrtar të qeverisë së Kosovës.

61 Elton Tota, “Ngritet Barrikadë në Mitrovicë”, 18 qershor 2014.

<http://www.balkan.eu.com/barricade-lifted-mitrovica>

Shqiptarët filluan të vozisin automjetet nëpër urë, të veshur me veshje tradicionale dhe me plisa të bardhë duke kënduar triumfalisht, gjë e cila alarmoi banorët e veriut.

Ky ngazëllim ishte jetëshkurtër dhe të nesërmen kryetari i komunës veriore të Mitrovicës, Goran Rakiç njoftoi se ura do të bllokohej nga një "Park i Paqes", gjë e cila edhe një herë pengoi lirinë e lëvizjes së njerëzve në të dy anët e Mitrovicës.⁶² Ura u mbulua me baltë meqë kopshtarët mbjellën bar dhe përreth barit vunë pengesa me trungje pemësh.

Më 22 qershor, në anën jugore filloi një protestë e cila shpejt u përshkallëzua në përlëshje të plotë dhe u plagosën 23 persona. Parku vazhdon të jetë burim tensioni.

Ura tashmë është bërë temë e veçantë e diskutimit të ndërmjetësuar në Bruksel. BE-ja mbledhi një grup pune më datë 11 korrik i cili pas dhjetë orë diskutimesh përfundoi pa ndonjë rezultat. Më datë 22 korrik, palët sërish u takuan në mënyrë produktive, edhe pse nuk u arrit zgjidhje përfundimtare. Sipas një raporti të fundit nga Edita Tahiri, në Bruksel, të gjitha palët u pajtuan që BE-ja do "të bënte një vlerësim teknik të stabilitetit statik të strukturës së urës", që do të prezantohej në shtator të vitit 2014.⁶³ Tahiri gjithashtu është zotuar se po të ketë çfarëdo veprimi që synon vendosjen e barrikadave në urë, qeveria e Kosovës do të "përgjigjet me forcën e ligjit".

Në një hetim tjetër të veçantë të rreth sundimit të ligjit, në gusht, EULEX-i njoftoi se ekziston një urdhër-arresti për Stefan Vuloviç, kryetarin e komunës së Zubin Potokut, pasi që ai nuk u paraqit për t'u marrë në pyetje lidhur me çështjen e Slobodan Sovrliç-it. Sovrliç thuhet se kishte kryesuar një bastisje në stacionin e policisë në Zubin Potok, i cili kishte mundësuar lirinë e disa njerëzve që mbaheshin atje, 64 të cilët po mbaheshin për shkak të dyshimit për përdorim të armëve të zjarrit në një sulm mbi tre policë të Kosovës.⁶⁴

Vuloviç thuhet se ka lëshuar Kosovën, bashkë me ish-kryetarin Slavisa Ristiç, i cili është i dyshuar për rrezikim të personelit të OKB-së dhe për kryerje të një vrasjeje.⁶⁵

62 Raportimi në Mitrovicë më 19 qershor 2014.

63 Republika e Kosovës, "Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit: Raport i gjendjes janar-shtator 2014, Raporti i dorëzuar Bashkimit Europian/Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Europian nga ana e qeverisë së Republikës së Kosovës, 10 tetor, 2014. Faqe 20.

64 "Vendorët hyjnë në stacionin e policisë, lirojnë të arrestuar serbë", 13 mars 2014.

http://www.b92.net/eng/news/crimes.php?yyyy=2014&mm=03&dd=13&nav_id=89618
Sovrliç u arrestua në muajin maj dhe hetohet për "kryerje të një numri veprash të rënda penale, duke përfshirë edhe Rrezikim të personelit të OKB-së, Pengim të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare, pjesëmarrje në turmë që kreu veprë penale, sulmim të personelit dhe pronës së EULEX-it, dhe pjesëmarrje në arratisje të dhunshme", sipas një njoftimi për shtyp nga EULEX-i.

65 Intervistë e BIRN-it me Policinë e Kosovës, 1 Prill

66 <http://www.tanjug.rs/news/143178/warrants-for-arrest-of-stevan-vulovic--slavisa-ristic.htm>

Siguria

Integrimi i ish zyrtarëve policorë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë në një njësi të Policisë së Kosovës është përfunduar me sukses, ndonëse mbrojtja civile që sponzorohet nga Serbia⁶⁷ dhe strukturat e sigurisë akoma vazhdojnë të qëndrojnë. Integrimi i policisë paraqet arritje shumë të rëndësishme të marrëveshjes, gjë e cila ka pasur ndikim pozitiv në punën policore të Mitrovicës së veriut.

Sipas marrëveshjes, të gjithë policët që punojnë në veri të Kosovës duhet të integrohen në PK dhe të gjitha pagat të paguhen nga ky organ. Pjesëtarëve të strukturave tjera të sigurisë serbe do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.

Sipas marrëveshjes, një komandant rajonal, që do të jetë serb, do të mbikëqyrë njësinë e përbërë nga katër komunat me shumicë serbe në veri. Komandanti propozohet nga Ministria e Brendshme sipas listës së dhënë nga katër kryetarët e komunave.⁶⁸ Përbërja e njësisë rajonale do të pasqyrojë përbërjen etnike të katër komunave.

Deri në muajin maj 2014, 285 ish-punonjës të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, apo MUP-it, u integruan në Policinë e Kosovës. Këto shifra bëjnë që përfaqësimi etnik serb në Policinë e Kosovës të jetë 12.6%. Deri më datë 5 korrik 2013, të nëntë zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) u mbyllën. Sipas intervistave me oficerët e sapo-inkorporuar të policisë, kjo gjë ka rritur ndjeshëm praninë e policisë, sepse ka më shumë policë në patrulla.⁶⁹

Nenad Djuriç, më 25 qershor të vitit 2013 u emërua komandant rajonal.

Ligji i Kosovës parasheh ndarjen në vetëm gjashtë rajone policore për tërë territorin, por Marrëveshja fuqizonte krijimin e një njësie të veçantë shtesë për veriun. Më 22 korrik 2013, Kosova miratoi ligjin me të cilin ndryshoi kornizën ligjore për të mundësuar krijimin e Qendrës Rajonale të Veriut.

Integrimi ishte paraparë të fillojë nga mesi i qershorit të vitit 2013, kur Kosova të shpallte konkurset për pozita në Policinë e Kosovës (PK). Megjithatë, pati disa vonesa në këtë proces. Sipas një raporti të qeverisë së Kosovës, Serbia është dashur që më datë 16 shtator të atij viti të paraqesë listën e individëve që do të integroheshin në institucionet e sigurisë së Kosovës, por lista nuk u pranua deri më datë 11 dhjetor.⁷⁰ Drejtoria e Policisë së MUP-it në Mitrovicë i ofroi Beogradit listen prej 337 individëve të gatshëm për integrim. Beogradi pastaj i dha këtë listë qeverisë në Prishtinë, gjatë një prej takimeve në Bruksel. Pastaj, Ministria

67 Civilna Zastita, e njohur në shqip si "Mbrojtja Civile" është emri që i jepet njësisë që janë përgjegjëse për sigurinë lokale. Në vitin 1990 dhe fillim të viteve 2000 ajo vepronte në kuadër të Ministrisë Serbe të Mbrojtjes. Tani, ato janë të rregulluara me ligj serb nën Ministrinë e Brendshme dhe udhëhiqet nga qeveritë komunale si ndërhyrje e parë në situata emergjente, duke përfshirë përmbajtjet dhe tërmetet. Qeveria e Kosovës i konsideron ato si strukturat paramilitare që operojnë ilegalisht në Kosovë. Anëtarët e strukturës në Leposaviq thanë për BigDeal se detyrat kryesore të tyre lidhen me mirëmbajtjen e zonës komunale, për shembull pastrimin e rrugëve të mbuluar nga dëbora, riparimin e urave dhe infrastrukturës tjetër. Bashkimi Europian ka thënë në intervistë për Big Deal se ato duhet të shpërbëhen dhe të integrohen në organet përkatëse të Kosovës.

68 Sipas marrëveshjes, katër kryetarët e komunave planifikohet që këtë listë ta hartojnë në emër të Asociacionit/Komunitetit, por ai nuk është formuar ende.

69 Intervistat me Nenad Djuriç, drejtor i Policisë së Mitrovicës së veriut, Zëvendës Drejtorin Besim Hoti, të bëra më 29 Prill 2014. Lexo më shumë këtu: <http://www.balkaninsight.com/en/article/serb-police-adapt-to-new-bosses-in-kosovo>

70 Raporti i gjendjes (State of Play report)

e Punëve të Brendshme e Kosovës kreu verifikimet dhe kontrollet e sigurisë mbi këta individë. PK bëri verifikim të historisë penale të punonjësve të rinj potencialë, për të siguruar se ata nuk kishin kryer krime të cilat nuk përfshihen në ligjin e amnitisë që u dha në shtator.⁷¹ Nga lista e plotë prej 337 ish-zyrtarësh të MUP-it që iu paraqit Prishtinës, 52 nuk u ftuan për punësim, ose për shkak se ata nuk donin me të vërtetë që t'i bashkohen PK-së, për shkak se nuk kishin përmbushur kërkesat, ose për shkak se mungonte e verifikimi i sigurisë. Gjatë proces, një pjesë tjetër prej 800 ish-punonjësish të MUP-it në pjesët qendrore dhe lindore të Kosovës u pensionuan pas një urdhri të lëshuar nga Qeveria e Serbisë më datë 26 dhjetor të vitit 2013.⁷² Kjo shkaktoi protestë të rreth 1000 ish-punonjësve dhe Sindikata e Policisë së Serbisë lëshoi një deklaratë me të cilën kritikonte këtë vendim duke e quajtur atë të paligjshëm.

Të rekrutuarit e rinj u trajnuan në muajin shkurt në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Programi i trajnimit, që zakonisht zgjat nëntë muaj, u ngjesh në vetëm një javë, dhe u fokusua në ligjërata rreth sistemit ligjor të Kosovës dhe prezantim të pajisjeve.⁷³

Zyrtari policor Milorad Mitrović tha për BigDeal se inkorporimi i zyrtarëve të MUP-it nënkuptoi se do të ketë më shumë policë në patrulla, duke bërë që Mitrovica e veriut të jetë më e sigurt. Ai pohoi se nuk e kishte problem pranimin e shefit të ri pas 20 vitesh pune për Beogradin. “Beogradi më nuk ma ndikon punon dhe kaq. Ne jemi zyrtarë policorë profesionistë”.⁷⁴

Zyrtari policor Miodrag Lekić e thotë këtë ndryshe. “Njerëzit na shohin me të njëjtin sy siç shohin çfarëdo policie – nuk na duan!...Apo, na duan pakëz më shumë se sa që e duan EULEX-in”, tha ai për BigDeal.⁷⁵

Shpërbërja e strukturave tjera të sigurisë paraqet storie në vehte. Deri në fund të vitit 2013, pjesëtarët e strukturave të Sigurisë së Serbisë duhej të inkorporoheshin plotësisht në strukturat ekuivalente të Kosovës – Polici, Intelejencë, Ndërrhyrje Emergjente – dhe pagat t'u paguhen ekskluzivisht nga buxheti i Kosovës.

Nuk ka patur kurrfarë progresi sa i përket shpërbërjes së strukturave të ashtuquajtura Civilna Zastita (Mbrojtja Civile). Në ish Jugosllavi, këto organizata ishin pjesë e ushtrisë. Tash, ato rregullohen përmes ligjit të Serbisë për Gjendje Emergjente, si ndërhyrje të para në situata emergjente të cilat përfshijnë vërshime apo tërmete. Këto njësi hyjnë nën juridiksionin e qeverive lokale, dhe kryejnë operacione të cilat autoritetet lokale të Kosovës akoma nuk kanë kapacitetin për



“Njerëzit na shikojnë në të njëjtën mënyrë siç shikojnë çfarëdo policie – nuk na duan! ...Ose, na duan pakëz më shumë se sa që e duan EULEX-in”.
—MIODRAG LEKIĆ,
ZYRTAR I POLICISË
SË KOSOVËS

71 Një raport i Forumit Hulumtues të Sigurisë mbi implementimin e integritimit të policisë e përshkruan procesin e verifikimit, duke bërë kritika se ai është kryer shumë shpejt http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/04/police_integration_nk_web.pdf

72 Qeveria e Republikës së Serbisë, 2013, Uredba o uslovima za ostvarenje prava na posebnu penziju zaposlenih u Ministarstvu unutrašnjih Poslova na teritoriji AP Kosova i Metohija, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 55/05, 71/05.

73 Po aty.

74 Intervistë në veri të Mitrovicës në maj 2014.

75 Për të lexuar më shumë mbi integrimin e ish-oficerëve të MUP-it në Policinë e Kosovës, shih “Policia Serbe përshtatet me Shefat e rinj”, Balkan Insight, 1 maj, 2014. <http://www.balkaninsight.com/en/article/serb-police-adapt-to-new-bosses-in-kosovo>

ta bërë në pjesën veriore.

Ndonëse qëllimi zyrtar i tyre ishte ndërhyrja në emergjenca, qeveria e Kosovës i konsideron ato si organizata paramilitare të jashtëligjshme, kjo me gjasë për shkak se disa pjesëtarë të tyre ishin tek barrikadat në vitet e kaluara dhe merrnin pjesë në trazirat e dhunshme. Zyrtarë të Bashkimit Europian kanë thënë gjatë intervistave për BigDeal se i konsiderojnë ato si grupe të armatosura dhe të uniformuara, të cilat duhen çmontuar.⁷⁶

Pjesëtarë të njërive të Mbrojtjes Civile me të cilët është takuar BigDeal në veri të Kosovës pohojnë se roli i tyre është parësisht humanitar, dhe se ata janë si lloj ndërhyrje e parë tek popullatat fshatare. Kur vërshimet e mëdha shkatërruan Serbinë, 90 pjesëtarë të Mbrojtjes Civile u mobilizuan për të dërguar ndihma.⁷⁷

“Ne nuk jemi pjesë e problemit, ne jemi pjesë e zgjidhjes”, tha për BigDeal zëvendës-kreu i mbrojtjes civile në Leposaviq, edhe pse nuk desh të dihet me emër. “Ne nuk kemi strukturë ushtarake, dhe nuk funksionojmë si ushtri. Ne i ndihmojmë departamentit të zjarrfikësve, dhe ndihmojmë në pastrimin e rrugëve të fshatrave në kohët e dimrit në mënyrë që ato të bëhen të kalueshme për banorët”.⁷⁸

Në shtator, pjesëtarë të strukturës në Leposaviq thanë për Big Deal se detyra e tyre kryesore ka të bëjë me mirëmbajtjen e zonës komunale, për shembull pastrimin e rrugëve nga dëbora, riparimi i urave dhe infrastrukturës tjetër. Ata përmendën planet e tyre për të angazhuar pjesëtarë tjerë të Mbrojtjes Civile, të paguar nga buxheti i Serbisë.⁷⁹

Sipas një raporti nga Zëvendës-kryeministrja Edita Tahiri, “facilitatorët e BE-së nuk mundën të bindin palën Serbe që të hyjnë në diskutim për këtë çështje deri në takimin e fundit në dhjetor të vitit 2013, në nivel Kryeministrash dhe Përfaqësueses së Lartë Eshton, në të cilin BE-ja prezantoi një pilot-propozim për zgjidhje të çështjes. Qeveria e Kosovës pohon se Serbia është “vonuar në prezantim të planit të shpërbërjes”, ndërkohë që edhe BE-ja duhet të prezantojë “Itinerarin e shpërbërjes së të ashtuquajturit shërbim të mbrojtjes civile”.⁸⁰

Petar Miletiç tha për BigDeal se: “Civilna Zastita është e rrezikshme shikuar për nga aspekti i asaj se institucionet e Kosovës nuk kanë mjete për t’i futur të gjithë në listë të pagave”. “Çdo person që e di se do të lirohet nga puna dhe se nuk do të mund të mbajë familjen e vet mund të bëhet i rrezikshëm. Këta njerëz është më lehtë të manipulohen”.⁸¹

76 Shih Raportin e gjendjes, janar 2014, faqe 9.

77 Civilna zaštita sa severa KiM u pripravnosti za pomoć ugroženim mestima u Srbiji, 15 Maj 2014. http://www.kossev.info/strana/arhiva/civilna_zastita_sa_severa_kim_u_pripravnosti_za_pomoc_ugrozenim_mestima_u_srbiji/1555

78 Intervistë në Leposaviq në shtator 2014.

79 Lideri i Srpska Lista-s, Aleksandar Jablanović, tha për Big Deal se me ndihmën e Ministrisë Serbe të Punës, Aleksandar Vulin, komuna do të punësojë 250 punonjës të rinj, mes të cilëve 50-100 do të shpërndahen në njësitë e Mbrojtjes Civile.

80 Qeveria e Kosovës, Raporti i gjendjes, tetor 2014, faqe 13.

81 Intervistë në Graçanicë në tetor 2014.

Gjyqësori

Përfaqësues nga Kosova dhe Serbia janë pajtuar se autoritetet ekzistuese gjyqësore do të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë duhet të krijojë një panel të përbërë nga shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovës që do të merren me të gjitha komunitatet me shumicë serbe të Kosovës. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë si nga staf administrativ ashtu edhe gjyqtarë, do të ketë seli të përhershme në Mitrovicë veriore. Secili panel i divizionit të mësipërm do të përbëhet nga shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovës.

Plani i implementimit i 22 majit bënte thirrje për integrim të plotë të autoriteteve gjyqësore të veriut deri në fund të vitit 2013. Kjo gjë nuk ka ndodhur, dhe tani duket se ka më pak gjasë se kjo do të ndodhë deri në fund të vitit 2014. Kjo gjë ka krijuar një vakum serioz për drejtësinë.

I njëjti plan bëri thirrje për krijimin e një grupi punues për krijimin e planit gjithëpërfshirës për zbatim të nenit 10, dhe për të rënë dakord mbi datën dhe planin e qëndrimit të rasteve të reja për shqyrtim në gjykatat e Serbisë. Nga mesi i qershorit, Serbia duhej t'i ofronte informata Kosovës rreth asaj se cilët zyrtarë gjyqësorë ishin të interesuar t'i bashkoheshin institucioneve të Kosovës, sa më shpejt që të miratohej ligji i amnistisë i cili garanton se ata që janë fajtorë për krime jo të rënda nuk do të ndiqeshin penalisht (ligji i amnistisë nuk hyri në fuqi të plotë deri në shtator të vitit 2013).⁸²

Nga mesi i qershorit "Përbërja e gjyqësorit duhej të pasqyronte përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilës gjykatë përkatëse". Deri më sot, kjo gjë nuk ka ndodhur.

Gjykatat e Serbisë u pajtuan se do të gjykonin rastet e paraqitura deri para datës 15 korrik 2013 dhe se do t'i nxjerrnin vendimet deri më 1 shtator 2013. Gjykata më pas do mbyllej. Ky afat kohor krijoi një vakum serioz për drejtësinë në veri. Më datë 17 qershor 2013, Serbia vendosi që pas 15 korriku 2013, të gjitha kërkesat për hetime të reja apo rastet mund të ruhen vetëm për zgjidhje të mëvonshme nga ana e gjykatave të Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2013, të dy palët arritën një marrëveshje e cila parasheh një gjykatë themelore dhe një prokurori themelore për rajonin e Mitrovicës. (Gjyqësori do të vazhdojë të operojë me një Gjykatë Supreme dhe një Gjykatë të Apelit). Qeveria e Kosovës thotë se kjo gjë "ka hapur perspektivat për procesin e integrim-it", por se procesi po pengohet nga logjika etnike e atyre gjykatave të cilat është duke i kërkuar Serbia". Qeveria e Serbisë do që mosmarrëveshjet që parashtrohen nga pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës të gjykohen nga gjyqtarë serbë, ndërsa që qeveria e Kosovës pohon se "drejtësia si vlerë universale nuk mund të ndahet nga kurrfarë linjash".

Edhe pse ato duhej ndërprerë deri më 1 shtator 2013, gjykatat paralele serbe kanë vazhduar të merren me "çështje urgjente civile", por jo edhe me raste penale. Në intervistat e dhëna për BigDeal, pjesëtarët e gjyqësorit thanë se zyrtarët gjyqësorë vazhdojnë të marrin pagat nga Serbia, edhe pse ato nuk kanë zgjidhur



"Ne nuk jemi pjesë e problem-it, ne jemi pjesë e zgjidhjes."

—ZËVËNDËS SHEFI
I MBROJTJES CIVILE
TË LEPOSAVIQIT

82 Për më shumë informacion, shih seksionin e plotë mbi Ligjin e Amnistisë.



“Qeveria e Beogradit na mban si mbi akull. Na kanë kufizuar aktivitetet dhe na kanë ndaluar veprimin jashtë autoritetit zyrtar. Në të njëjtën kohë mungojnë udhëzimet për autoritetin tonë. Na ndalohe komunikimi me publikun dhe me mediat. Ne pranojmë paga të cilat nuk i meritojmë. Nuk ka strategji publike rreth asaj se çka duhet të bëjmë ne dhe për sa kohë

—NJË GJYQTAR NGA ZVEÇANI

asgjë përveç rasteve urgjente.⁸³ Në ndërkohë, rastet penale nuk mund të paraqiten në veri, gjë që e bën atë gjithnjë e më shumë pa ligj.

“Kam frikë se – sidomos kur është fjala për krimin, dhe për krimet për të cilat dënimi është deri në dhjetë vjet burg – ka një lloj vakuumi ligjor nga i cili do të përfitojnë njerëzit qëllim-keq”, tha Marko Djuriç për BigDeal.

Në Bruksel pati një takim më datë 12 shkurt 2014 në të cilin palët me sa duket zvogëluan disa prej dallimeve mes tyre. Të dyja palët thanë për mediat se ata i ishin afruar përmbylljes së marrëveshjes, e cila do të nënshkruhej pasi që të dyja palët të kishin formuar qeveritë.

Struktura e saktë e gjykatës së Mitrovicës, numri i të punësuarve gjyqësorë dhe shpërndarja e tyre etnike tani për tani mbesin që të gjitha çështje të hapura.

Djuriç fajësoi qeverinë e Kosovës për ndërprerjen e negociatave. “Diku gjatë procesit nuk shihej më vullneti politik”, tha ai. “Kam bindjen se nuk ishte në vullnetin e institucioneve përfaqësuese të Prishtinës që marrëveshja të finalizohet”.⁸⁴

Diskriminimi

Marrëveshjet për strukturën dhe përbërjen e policisë dhe të gjykatave krijojnë vende pune, në baza etnike: komandanti policor i komandës rajonale të PK-së në veri duhet të jetë serb, gjykata e apelit do të krijojë panel gjyqtarësh me shumicë serbe që do të të merret me të gjitha komunat me shumicë serbe, dhe një divizion i përbërë nga shumicë gjyqtarësh serbë, do të keni seli permanente në veri.

Marrëveshjen e 19 prillit e sfiduan në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës parlamentarë nga radhët e Vetëvendosjes, për shkak se, ndër të tjera, ky sistem do të ofronte vende pune për zyrtarë të gjyqësorit dhe policisë në bazë të përkatësisë etnike. Gjykata refuzoi të shqyrtojë rastin, duke thënë se marrëveshjet ndërkom-bëtare nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor kushtetues.

Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës thotë se, “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që garantoohen me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ)”. Në vitin 2009, në aktvendimin rreth rastit “Finçi-Sejdiç”, GJEDNJ-ja vendosi se dispozita e kushtetutës së Bosnjë dhe Herzegovinës, e cila parasheh presidencë tre-anëtarëshe të përbërë nga një serb, një kroat dhe një boshnjak shkel standardet europiane të të drejtave të njeriut. Kjo gjë krijon një precedent në praktikën gjyqësore të Konventës Europiane i cili mund të përndjek marrëveshjen e rënë dakord mes Beogradit dhe Prishtinës.

Shkresat: diplomat, regjistri i gjendjes civile, kadastri

DIPLOMAT: Njohja reciproke e diplomave universitare është çështje me shumë rëndësi si për shqiptarët që jetojnë në Serbi ashtu edhe për serbët që jetojnë në Kosovë. Më datë 21 nëntor 2011, të dyja palët u pajtuan që “të kërkojnë nga Shoqata e Universiteteve Europiane që të vërtetojnë diplomat universitare të lëshuara

⁸³ Intervistat me gjyqtarët dhe stafin gjyqësor në veri të Mitrovicës, gusht 2014.

⁸⁴ Intervistë në Mitrovicën e Veriut në shtator 2014.

nga universitetet e secilës palë për përdorim nga pala tjetër sa i përket edukimit të mëtejshëm dhe/ose punësimit publik”.

Implementimi filloi në shkurt të vitit 2012 dhe në muajin gusht të vitit 2014 362 aplikime nga Kosova dhe 13 aplikime nga Serbia u miratuan dhe u lëshuan certifikatat e nostrifikuara (njohja e diplomave nga një vend i jashtëm). Ky është numri i pranishëm nga gjithsej 408 aplikues nga Kosova dhe 25 aplikues nga Serbia.

Procesi i nostrifikimit mbikqyret nga SPARK, një OJQ holandeze që fokusohet në arsim të lartë dhe ndërmarrësi.⁸⁵ SPARK ka vepruar si palë e tretë, duke marrë aplikimet për nostrifikim dhe duke i dorëzuar ato EUA (Shoqatën e Universiteteve Europiane). Mirëpo, kontrata e saj dy-vjeçare përfundoi në fillim të vitit 2014 dhe ende nuk është ripërtërirë nga BE-ja. “Sipas raportit të qeverisë së Kosovës të muajit tetor 2014”, pati vetëm një rast në të cilin u dha njohje zyrtare nga ana e autoriteteve në Serbi për certifikim diplome e cita bazohej në dialogun e që vinte nga institucionet e arsimit të lartë të Kosovës”.⁸⁶ “Sipas raportit të progresit për vitin 2014 nga Komisioni European, Serbia ka pranuar vetëm pesë diploma të certifikuar nga Kosova, pas një procesi shtesë nostrifikimi.

Ka pasur edhe raste kur nxënësit edhe pse kishin diploma të nostrifikuara, ato nuk janë njohur. Një student, i cili kishte diplomë në drejtësi nga Nishi i Serbisë, nuk ishte në gjendje t’i nënshtrohej provimit të jurisprudencës në Kosovë deri me ndërmjetësimin e zëvendëskryeminstres Tahiri.

Teksti i marrëveshjes nuk përmend “Universitetin e Prishtinës”, të nodhur në Mitrovicë, i cili drejtohet sipas sistemit të Serbisë. Universiteti ka 14 fakultete dhe është akredituar nga Serbia. Qeveria e Kosovës ka vendosur që ajo diplomë nuk mund të akreditohet, ndërsa pala serbe mendon se ajo duhet të konsiderohet brenda skemës së universiteteve të Serbisë. Sipas negociatorit serb, Borko Stefanović, në dialog nuk u diskutua qartazi. Serbët e Kosovës të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë nuk janë të kualifikueshëm për pozita në qeverinë e Kosovës apo në institucionet që obligojnë diplomë universitare, ata nuk mund t’i nënshtrohen provimit të jurisprudencës në Kosovë, gjë e cila do t’u mundësonte atyre të plotësojnë pozita në sistemin gjyqësor të Kosovës. Kjo gjë dëmton perspektivat e punës për serbët e Kosovës të cilët studiojnë në këtë universitet, si i vetmi universitet në gjuhën serbe në territorin e Kosovës, njëjtë edhe për pakicat sikurse goranët, të cilët dëshirojnë të arsimohen në gjuhën serbe, që është më e përafërt me gjuhën e tyre amtare.⁸⁷

“Shpresoj se do t’ia dal që pas një apo dy muaj të diplomohem”, tha për BigDeal studenti i mjekësisë Brdar Dragić, një 25 vjeçar nga Karlovaci i Kroacisë. “Pas kësaj, kam planifikuar të kthehem në shtëpi në Kroaci. Mirëpo, për shkak të problemeve me diplomën time kam bërë plan që të qëndroj në Beograd dhe të bëj praktikë profesionale 6 muaj. Pas kësaj, unë nuk e di se çka do të bëj. Mund të punoj në Serbi me diplomën time, por në Serbi nuk ka punë për mjekët. Kroacia

85 Shih faqen e internetit të SPARK për më shumë informacion: <http://www.spark-online.org/about-us/> dhe specifikiisht për Kosovën: <http://www.spark-online.org/region/kosovo/>

86 Raporti i gjendjes, tetor 2014, faqe 24.

87 Intervistë me anëtar të komunitetit goran në qershor 2014.

dhe vendet e tjera të Bashkimit Europian kanë mungesë të mjekëve. Megjithatë, diploma ime njihet vetëm në vendet që nuk e kanë njohur Kosovën. Prindërit e mi kanë investuar shumë në mua. Unë kam investuar me shumë përpjekje në arsimin tim. Vite e vite mësim... Për çka? Për asgjë".⁸⁸

Regjistri civil

Para dhe gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999, regjistrat e gjendjes civile të Kosovës u shkatërruan, dogjën, ose u dërguan në Serbi. Më datë 2 korrik 2011 u arrit një marrëveshje mbi regjistrin civil për të skanuar dokumentet origjinale, për t'i vërtetuar ato, dhe për t'i dorëzuar kopjet Kosovës. Implementimi filloi më 6 dhjetor. Dokumentet u skanuan në Nish nga ekipe trepatëshe. Ishte parashikuar periudhë prej nëntë muajsh, dhe edhe pse transferimi i plotë i dokumenteve zgjati më shumë, procesi përfundoi në mars të vitit 2014.

Besim Jonuzaj, ushtrues detyre i drejtorit të Departamentit të Regjistrimit civil, konfirmoi për BigDeal se në total 12,391 regjistra janë kthyer në Kosovë.⁸⁹ Regjistrat janë kopje të certifikuara të origjinalit, dhe ato përfshijnë shënimet e lindjes, martesës dhe vdekjes për qytetarët e Kosovës të lindur mes viteve 1850 dhe 1999.

Kadastrri

Për dallim prej dokumenteve të regjistrit civil, janë pranuar vetëm 0.02% dokumente kadastrale nga gjithsej 12 milionë sosh të cilat Kosova shpreson t'i kthejë nga Serbia. Ndryshimet në popullsinë e Kosovës gjatë dhe pas luftës nënkuptojnë se pronat kanë ndryshuar duart, shpesh herë në mënyrë të paligjshme.

Më datë 2 shtator 2011 në Bruksel u arrit një marrëveshje dhe më 21 dhjetor të të njëjtit vit u dakordua rreth një plani implementimi.⁹⁰ Marrëveshja parasheh se kopjet e skanuara të të gjitha regjistrave kadastrale të para vitit 1999 të larguar nga Kosova do t'i dorëzohen EUSR-së. Një agjenci teknike pastaj do të krahasojë të gjitha kopjet me Agjencinë e rikonstruktuar Kadastrale të Kosovës, dhe në qoftë se ka mospërputhje, ato do të gjykohen nga një organ i tretë.

Kosova planifikojë se do të përgatiste legjislacionin e saj në përputhje me shpalljen e një ligji i cili krijon Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKVP), i cili do të pranonte dokumentet e skanuara. Ligji ende nuk është miratuar nga ana e parlamentit.


Procesi i skanimit të dokumenteve filloi në muajin janar të vitit 2012, me 3 milionë euro nga fondet e Bashkimit Europian me parashikim që të zgjasë dy vjet dhe të përfundojë deri në fund të vitit 2014.⁹¹ Kjo nuk do të ndodhë. Sasia e parë e dokumenteve, e përbërë nga 37,000 copë, apo 0,002% të totalit, u pranua nga Përfaqësuesi Special i BE-së, Samuel Zhbogar më datë 24 janar 2014. Megjithatë, një zëdhënës i agjencisë kadastrale të Kosovës pohon se ai nuk ka marrë asnjë

⁸⁸ Biseda me Brdar në tetor 2014.

⁸⁹ Deklaratë e Jonuzajt në gusht 2014.

⁹⁰ http://www.kossev.info/strana/arhiva/uredba_o_osebno_m_nacinu_obrade_podataka_katastarskih_knjiga_za_kosovo_i_metohiju__neustavna_i_nezakonita_/2113

⁹¹ http://www.kossev.info/strana/arhiva/uredba_o_osebno_m_nacinu_obrade_podataka_katastarskih_knjiga_za_kosovo_i_metohiju__neustavna_i_nezakonita_/2113



Prindërit kanë investuar shumë në mua. Unë kam investuar duke bërë përpjekje të madhe për arsimim. Vite e vite mësim... Për çka? Për asgjë.

—STUDENT I UNIVERSITIT TË PRISHTINËS I ZHVENDOSUR NË MITROVICË, BRDAR DRAGIÇ

dokument nga Serbia apo nga zyra e Zhbogarit, me gjasë për shkak se ata së pari duhet të kalojnë nëpër Agjencinë e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës e cila tek pritet të formohet (AKVP).⁹²

Një zëdhënës i BE-së tha për BigDeal se kjo ndodh për shkak se nuk është rënë dakord për atë se sa dokumente duhet të dorëzohen brenda një periudhe kohore.⁹³

AKVP duhet të themelohet nga ana e parlamentit të Kosovës, megjithatë, Vetëvendosje kundërshtoi ligjin e propozuar për krijimin e saj, sepse dëshiron që asnjë anëtar i kësaj agjencie të mos jetë ndërkombëtar. Megjithatë, sipas projekt-ligjit, dokumentet kadastrale duhet më parë t'i dorëzohen palëve ndërkombëtare.

“Është faji jonë që nuk miratua ligjin i cili do të lejonte krijimin e një agjencie teknike për verifikimin e dokumenteve i cili do të kontrollonte dokumentet pasi që ato të ktheheshin nga Serbia në Kosovë”, tha zëvendës-kryeministrja Edita Tahiri për BigDeal në një intervistë në tetor të vitit 2014.

Më datë 30 janar 2014, Gjykata Kushtetuese e Serbisë deklaroi se marrëveshja për kadastrën ishte jokushtetuese. Në vendimin e saj të publikuar më 1 gusht, ajo deklaroi se vendimi ishte jokushtetues, sepse ndonëse qeveria premtoi miratimin e ligjit mbi procesin e transferimit, nuk ekziston asnjë ligj.

Sipas një raportit të kohëve të fundit mbi gjendjen e implementimit të dialogut, qeveria e Serbisë lëshoi një dekret më datë 21 gusht 2014 duke udhëzuar që procesi i skanimit kadastral të vazhdojë tutje.

Kosova dhe bota

Dialogu ka ndihmuar Kosovën në avancim të marrëdhënieve me pjesën tjetër të botës, krahas avancimit të marrëdhënieve me Serbinë. Në maj të vitit 2013, Kosova dhe Serbia u pajtuan për shkëmbim të zyrtarëve të ndërlidhjes. Mandati i tyre është për monitorimin dhe angazhimin e të gjitha çështjeve lidhur me normalizimin e marrëdhënieve. Secili prej tyre ka zyre në delegacionet e BE-së. Zyrtarët arritën më datë 15 korrik 2013, dhe filluan punën më datë 17 korrik.

Zyrtari i Kosovës në Serbi ishte Lulzim Peci, por qëndrimi i tij zgjati vetëm dy ditë. Largimi i tij nuk u shpjegua plotësisht në deklaratën zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës.

Ai u zëvendësua nga Valdet Sadiku, i cili paraprakisht kishte qenë ambasador në Kroaci. Më datë 25 korrik, zyra e Kosovës zyrtarisht filloi punën. Sadiku kishte ca vështirësi sa i përket logjistikës dhe operativitetit formal të qëndrimit në Beograd, duke përfshirë edhe atë se u pengua me rastin e fluturimit për në Bruksel nga Beogradi, siç edhe u përshkrua në raportin e vitit 2014 të gjendjes nga ana e Tahirit, por këto çështje tanimë janë zgjidhur.

Zyrtari ndërlidhës i Serbisë është Dejan Paviçević. Në vitin 2008, Paviçević shërbeu si shef i kabinetit të zyrës së Serbisë për Kosovën dhe ishte pjesë e ekipit negociator të kryeministrit Ivica Dačić në Bruksel.

Që të dy zyrtarët kanë mbajtur profil të ulët, kanë pasur aktivitete të pakta

⁹² Deklaratë nga Denis Pitarka, Zyrtar për Informim në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bërë nga BIRN 18 gusht 2014.

⁹³ Deklarata nga zëdhënësi i BE-së, Stojan Pelko, gusht 2014.

publike, dhe në intervistat për BigDeal kanë refuzuar të flasin në hollësi rreth aktiviteteve të tyre.


Kosova gjithashtu ka zgjeruar marrëdhëniet e saj me shtete tjera dhe organe ndërkombëtare, si rrjedhojë e dialogut. Neni 14 i marrëveshjes së 19 prillit thotë “është rënë dakord se asnjëra palë nuk do të bllokojë, dhe nuk do të nxisë të tjerët që ta bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugëtimet e tyre përkatëse drejt BE-së”. Ky nen, i cili provokoi debat në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë, duket se është çështje e vullnetit të mirë më shumë se sa që është çështje për t’u shqetësuar.

Me shpërbërjen e Jugosllavisë, numri i forumeve rajonale u shumëfishua disa herë. Kosova kërkon të jetë pjesë e këtyre organizatave. Kosova ka shënuar ca progres në afrimin me këto organe rajonale. Në janar, zëvendës ministrja e jashtme, Tahiri, shkroi se ka pasur “pengesa të vazhdueshme nga pala Serbe” të cilat ndonjëherë zgjidheshin me mbështetje të BE-së. Tahiri shkroi se “fakti që nevojitet ndërhyrje e BE-së për të larguar ato pengesa është dëshmi e mos implementimit të kësaj Marrëveshje nga ana e Serbisë”.⁹⁴ Më datë 2 korrik 2014, ish Zëvendës-kryeministri i Serbisë dhe aktualisht Ministër i Punëve të Jashtme, Ivica Dačić, tha se do të parandalonte anëtarësimin e Kosovës në organizata rajonale “përveç nëse kjo gjë është në harmoni me marrëveshjen e Brukselit”. Megjithatë, Serbia miratoi një urdhëresë me të cilën paraqitja e Kosovës me fusnotë bëhej e pranueshme për Beogradin.⁹⁵

Më datë 28 shkurt 2013, Kosova iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), dhe më datë 23 nëntor 2013 Shkollës Rajonale të Administratës Publike (RESPA). Në vitin 2014, Kosova u bë pjesëmarrëse me drejtë të barabartë e Procesit të Bashkëpunimit në Europën Jug-Lindore (SEECIP), anëtare e plotë e Iniciativës Rajonale të Migrimit, Azilit dhe Refugjatëve (MARRI), dhe fitoi anëtarësi të plotë në Komisionin e Venedikut.⁹⁶ Kosova planifikon të aplikojë për anëtarësim të plotë në Këshillin e Europës deri në fund të vitit 2014, kjo sipas Zëvendës-ministrit të Punëve të Jashtme, Petrit Selimi.⁹⁷

Kosova akoma ka pasur telashe në përfitim të qasjes në këto organizata:

Qendra për Bashkëpunim në Siguri (RACVIAC), Qendra e Europës Jug-lindore për Zbatim të Ligjit (SELEC), Drejtorinë Europeane për Cilësi të Mjekësisë dhe Kujdesit Shëndetësor, Iniciativën për Bashkëpunim European, dhe në Konventën e Europës Jug-lindore për Bashkëpunim Policor.⁹⁸



“Unë dua që më në fund të kemi një gjendje të pastër pa shtërngesa – ta di se kush e vodhi atë, kush e shiti atë. Nëse e kanë shitur, po gënjejnë”.

—POLITIKAN NGA
SERBIA

94 Shih Raportin e gjendjes të janarit 2014.

95 <http://www.tanjug.rs/news/135914/dacic--kosovo-did-not-become-seecp-member.htm>

96 Zyrarët nga zyra e Këshillit të Europës në Kosovë, thanë se anëtarësimi ishte kryesisht rezultat i mungesës së Rusisë në takimet e KE-së, për shkak të konfliktit aktual në Ukrainë.

97 Deklaratë për Big Deal nga Selimi në fillim të gushtit 2014.

98 Për më shumë mbi këtë temë, shih dy raportet e Tahirit mbi “gjendjen” e zbatimit të marrëveshjes së Brukselit.

Energjia dhe telekomi

Çështjet e Energjisë dhe telekomunikimit janë diskutuar dhe negociuar për mbi katër vite. Në marrëveshje është përcaktuar mesi i qershorit të vitit 2013 si afat përfundimtar për zgjidhje të çështjes. Së paku negociatat për energjinë kanë avancuar deri diku në muajin mars dhe kohëve të fundit është rënë dakord për planin e implementimit në shtator.

Deri sa të implementohet plani i ri, Kosova ka qenë e varur nga kompania energjetike shtetërore e Serbisë, Elektromreza Srbije (EMS), e cila teknikisht ka mundësinë që të fikë dritat po që se dëshiron një gjë të fillë dhe vazhdon t'ua shesë kapacitetet e rrjetit energjetik të Kosovës kompanive energjetike që kërkojnë të transferojnë energjinë nëpërmjet rrjetit të shtetit fqinj.

Rrjeti elektrik mes Kosovës dhe Serbisë është thellësisht i ngërthyer, dhe obligon bashkëpunimin meqë është e pamundshme që ato dyja të ndahen plotësisht.

Në kohën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ekzistonte frika se Serbia do të mund të ndante territorin përgjatë lumit Ibër, i cili ndan pjesën tjetër të Kosovës nga veriu. Popullata kryesisht serbe që jeton atje refuzoi të njohë Kosovën dhe ekzistonte shqetësimi se mos Beogradi do t'ia presë qasjen e Prishtinës në liqenin e Gazivodës, i cili furnizon 60 për qind të ujit të Kosovës. Uji përdoret për pije dhe për ftohjen e centralit kryesor të energjisë në Kosovë, të vendosur në Obiliq, 10 kilometra larg Prishtinës. Ky termocentral prodhon dy të tretat e energjisë elektrike të Kosovës, dhe mbyllja e tij do të kishte pasoja të rënda për të gjithë rajonin. Ndërkohë që kjo ishte teknikisht e mundshme, ndërprerja e tij do të kishte efekt të madh në stabilitetin e rrjetit të energjisë në Serbi dhe do të kishte ndikim të vogël në vendet fqinje si Rumania dhe Bullgaria.

Kosova mirëmban dhe operon me rrjetin e transmisionit nëpërmjet KOSTT-it (Operatori i Transmisionit, Sistemit, dhe Tregut të Energjisë i Kosovës). Firma shtetërore e Serbisë, EMS, ka në dorë kontrollin përfundimtar, ndonëse ai rrallëherë ka përdorur këto kompetenca. Pas një marrëveshje në muajin shkurt të vitit 2014, EMS pranoi t'ia dorëzojë kontrollin KOSTT-it, ndonëse kjo gjë akoma nuk ka ndodhur.

EMS ka penguar Kosovën në të kaluarën nga importi dhe eksporti i energjisë. Serbia ka vënë vazhdimisht në ankand shfrytëzimin e linjave të transmetimit që nga viti 2004, dhe si rezultat i kësaj qeveria në Prishtinë ka vlerësuar se mund të ketë humbur deri në 15 milionë Euro në vit, gjithsej 150 milion Euro që nga viti 2004.

Në fund të muajit shkurt 2014, KOSTT-i i Kosovës dhe EMS-i i Serbisë nënshkruan kornizën e marrëveshjes mbi parimet e operimit mes Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (OST) dhe një marrëveshje për kompensimin e të hyrave të humbura nga tranziti. Pikat kryesore përfshijnë:

- Demarkimin e kufirit mes dy sistemeve elektrike të cilat janë në përputhje me kufijt shtetërorë mes Kosovës dhe Serbisë;
- Themelimin e një zone të pavarur të kontrollit nga KOSTT, me fillim në janar 2015;
- Zonën e Pavarur Tregtare deri më 01.01.2015, gjë që nënkupton alokimin e kapacitetit të pavarur ndër-kufitar nga ana e EMS-së;

- Kompensimin nga ana e EMS-së për të hyrat e humbura nga tranziti i energjisë në rast të bllokimit të transmisionit ndër-kufitar.

Kosova nuk beson se do të merrë paratë që pohon se i ka humbur para nënshkrimit të marrëveshjes. Naim Bejtullahu, kryesues i KOSTT-it, tha për Big Deal se “KOSTT do të kompensohet për të gjitha paratë që ka humbur që nga marsi i vitit 2014”. Megjithatë, Bejtullahu tha se ishte skeptik se Kosova do të merrte çfarëdo shume parash të humbura para marsit të vitit 2014.⁹⁹

Lidhur me dominimin e vazhdueshëm të linjave të transmetimit Kosova është ankuar në vitin 2010 tek Komunitetit i Energjisë, organizata që ngarkohet me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të këtitilla në Europën Jug-Lindore. Vitin pasues, ky organ vendosi në favor të Kosovës, dhe urdhëroi Serbinë të ndalonte këtë, por EMS ka vazhduar të shesë kapacitetin përmes ankandit dhe të mbajë kontrollin.

“Sot, ankandi i kapaciteteve transmetuese nga kufiri i Kosovës drejt shteteve fqinje është ende nën administrimin e Serbisë”, tha Bejtullahu për Big Deal. “Ne kurrë nuk kemi pasur qasje në këtë proces, edhe kur energjia importohet nga ne”, tha ai.¹⁰⁰

Kosova përjetoi një ndërprerje të madhe të energjisë në vitin 2007, kur Serbia ndaloi importin e energjisë emergjente. Më datë 29 janar të atij viti, EMS gjithashtu bllokoi një dërgesë nga tregtari i energjisë EFT.

Nermine Arapi, drejtoreshë e KEDS-it, firmës private të Kosovës që është përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike, tha se pozicioni i Kosovës e bën eksportin e energjisë praktikisht të pamundshëm meqë ajo nuk mund të garantojë shpërndarjen pa mbështetjen e EMS-së.¹⁰¹

Si rezultat i kësaj, KEK-u ka qenë i detyruar që të reduktojë sasinë e energjisë që gjenerohej nga dy termocentralet e Kosovës, Kosova A dhe Kosova B, me qëllim që të shmang krijim të tepricës. Kjo i ka kushtuar Kosovës me humbje të eksportiit dhe ka zvogëluar efikasitetin e centraleve.

Sa i përket Telekomit, Kosova momentalisht përdor kodin e shtetit të Serbisë +381 dhe të Sllovenisë +386 për thirrjet telefonike fikse dhe dy operatorët celularë përdorin kodet e Sllovenisë dhe të Monakos, +386 dhe +377 respektivisht. Më datë 8 shtator 2013, u arrit marrëveshje për telekomunikacionin, pas rreth tre vitesh negociata. Kosova do të merrë kodin e vet shtetëror +383, ndërkaq Suedia, Italia dhe Austria ofruan që ato të aplikojnë për kod të ri telefonik në emër të Kosovës.

Bisedimet për implementimin e marrëveshjes kanë filluar në janar, por janë vonuar për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të qershorit në Kosovë. Zëvendës-kryeministrja Tahiri, në muajin mars tha për Big Deal se Kosova do të ketë kodin e saj deri në vjeshtë, ndërsa në maj ajo tha se do ta ketë kodin deri në janar të vitit 2015, por nuk është bërë asnjë përparim deri më tani që do të dëshmonte se kjo mund të ndodhë brenda këtij afati. Në tetor, Tahiri ia tregoi zgjidhjen

“Sot, ankandi publik i kapaciteteve të transmisionit nga kufiri i Kosovës drejt shteteve fqinje është akoma nën menaxhimin e Serbisë. Ne kurrë nuk kemi pasur qasje në këtë proces as kur energjia importohet nga ne dhe ne e paguanim”.

—NAIM BEJTULLAHU, SHEF I OPERATORIT TË TRANSMISIONIT TË ENERGJISË SË KOSOVËS

⁹⁹ Intervistë në gusht 2014.

¹⁰⁰ Po aty

¹⁰¹ Intervistë me Arapin në gusht 2014.

BigDeal-it, "Kjo gjë nuk është në duart tona".¹⁰²

Kosovo Parliamentarians have complained that they have never seen the agreement on Telecom, and therefore that it is not transparent.¹⁰³

Parlamentarët e Kosovës janë ankuar se kurrë nuk e kanë parë marrëveshjen për Telekom, dhe prandaj kanë thënë se ajo nuk është transparente.

Përfundim

Në vitin 2013, Serbia dhe Kosova kanë shënuar progres substancial në normalizimin e marrëdhënieve përmes Marrëveshjes profil-lartë të Brukselit më datë 19 prill dhe kanë shënuar zhvillime pozitive në implementim të marrëveshjes IBM. Optimizmi dhe momentum i fillestar ka shkuar në rënie në vitin 2014 në kohë kur Kosova hyn në muajin e pestë pa qeveri të formuar dhe ndërkohë që synimet e shesheve të politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini lidhur me dialogun mbesin të paqarta.

Deri më sot, procesi mund të ketë qenë i qytetëruar, por ka qenë larg nga të qenit monoton. Sulmet ndaj serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Serbi pas ndeshjes Serbi-Shqipëri tregojnë se situata mbetet e brishtë. Pa implementim të komponentëve kyç të marrëveshjes së 19 prillit e cila mund të bëjë që serbët e Kosovës të jetojnë normalisht: formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe themelimi i gjyqësorit funksional; marrëveshja ende mund të ngecë.

Me qëllim të ruajtjes së momentumit, është me rëndësi thelbësore që jo vetëm Beogradi por edhe Prishtina të mbajnë kanal të hapur, transparent dhe të drejt-përdrejt të komunikimit me katër komunat veriore, gjersa ndërkohë nuk shkelin vetë-qeverisjen autonome lokale.

Pasi të jetë vendosur korniza për asociacionin, e cila do të mbikëqyr funksionimin normal të institucioneve, Kosova duhet ta bëjë të qartë se ka pushtetin dhe vullnetin që me të vërtetë të mbajë sigurinë për të gjithë banorët e saj pakicë, posaçërisht në veri. Deri në atë kohë, Serbia do të ketë avancuar në procesin e kandidimit në BE, ndërkohë që kapitulli 35 do të mbetet i hapur. Ajo do të jetë koha kur Serbia dhe Kosova do të jenë gati të negociojnë zgjidhjen që do të trajtojë statusin e Kosovës.

Se kur do të ndodhë kjo varet natyrisht nga liderët e Prishtinës dhe Beogradit, dhe do të varet nga niveli i qeverisjes efektive që akoma nuk vlen në komunat veriore.

Me hapin që ka momentalisht dialogu si dhe implementimi i marrëveshjeve, do të duhen vite para se tregimi për Kosovën-Serbinë të zhvendoset në ormanin e së djeshmeve.

¹⁰² Intervistë me Tahirin në 21 tetor 2014.

¹⁰³ Deklaratë nga Deputetja e LDK-së Vjosa Osmani 17 shtator 2014.

Botuar nga:



